

# Raport i studimit

## Studim i përbashkët rreth mundësive dhe sfidave për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore

UNDP në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe UNDP Kosovë

*Qershor 2024*

### **Përgatitur nga:**

A. Emmett Boyer, Konsulent Ndërkombëtar – Specialist për çështje gjinore, klimatike dhe mjedisore

Sanja Ramić, Konsulente Kombëtare për Bosnjën dhe Hercegovinën – Specialiste ligjore për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut

Arijeta Himaduna, Konsulente Vendore për Kosovën<sup>1</sup> – Specialiste për çështje gjinore dhe barazi sociale

### **Koordinatorë të Programit:**

Alma Mirvic, Menaxhere e Projektit, UNDP Bosnjë dhe Hercegovinë

Marta K. Gazideda, Menaxhere e Portfolios së Qeverisjes dhe Ndërtimit të Paqes/Zëvendës Koordinatore e Programit, UNDP Kosovë

Ardian Latifaj, Menaxher i Projektit, UNDP Kosovë

Arijana Drinic, Udhëheqëse e Kërkimit, “UNDP Accelerator Lab” në Bosnjë dhe Hercegovinë

### **Mirënjohje:**

Ne jemi mirënjohës për të gjithë mbështetjen dhe komentet që kemi marrë në përgatitjen e këtij studimi. Faleminderit veçanërisht për (në rend alfabetik): Afrim Berisha, Albulena Sadiku, Amina Omičević, Amela Šabić Ahmečković, Amra Smajnović, Andrea Bevanda Hrvo, Arbenita Mjekiqi, , Arbëresha Loxha Stublla, Azra Berbić, Bojana Ilić, Branislava Crncević, Daniela Çoçaj, Dušan Radaković, Diesa Morina, Elita Ferati, Elirjeta Beka, Emina Veljović, Emir Delić, Fatmire Mani, Helena Poučki, Igda Lameš, Janja Hodić, Jasmina Husanović, Jelena Đokić, Jovana Radosavljević, Kemal Bajramović, Kreshnik Gashi, Lira Zajmi, Luljeta Koši, Liridon Salihi, Maida Bilal, Majda Ibraković, Maksuma Topalović, Majlinda Kelmendi, Miodrag Marinković, Miradije Gërguri, Muhamed Lopo, Naida Katica, Nera Monir Divan, Nita Ferizi Sadiku, Ozren Laganin, Petar Đorđević, Përparim Leka, Rina Haxhimehmeti, Razija Mezić, Sabina Jukan, Sabina Šahman Salihbegović, Sabina Topčić, Samir Lemeš, Sami Stagova, Sanela Popović, Sanja Čorović, Selvije Raci, Shpresa Gasalci, Shpresa Sheremeti, Snežana Jagodić, Sonja Kosanović, Stjepan Matić, Tijana Trbojević, Urim Xharavina, Valon Raka, Valon Xhabali, Violeta Vojin, Visar Prebeza, Vlora Veseli, and Zinaida Dimitrijevi

---

<sup>1</sup> Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

# Tabela e përmbajtjes

Akronimet.....	Error! Bookmark not defined.
<b>Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>iii</b>
<b>1 Hyrje.....</b>	<b>1</b>
1.1 Fushëveprimi dhe përmbajtja e studimit.....	2
<b>2 Metodologjia .....</b>	<b>3</b>
2.1 Korniza e hulumtimit.....	4
2.2 Intervistat me palë të interesit dhe punëtoritë e validimit.....	6
2.3 Kufizimet .....	6
<b>3 Bosnja dhe Hercegovina: Gjendja e angazhimit të grave dhe konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore .....</b>	<b>8</b>
3.1 Konteksti gjinor .....	8
3.2 Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor .....	11
3.3 Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave dhe konsideratat gjinore në qeverisjen mjedisore.....	12
3.4 Drejtësia procedurale – Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore .....	21
<b>4 Kosova: Gjendja e angazhimit të grave dhe konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore.....</b>	<b>24</b>
4.1 Konteksti gjinor .....	24
4.2 Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor .....	26
4.3 Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave dhe konsideratat gjinore në qeverisjen mjedisore.....	28
4.4 Drejtësia procedurale – Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore .....	34
<b>5 Përfundimet dhe rekomandimet .....</b>	<b>37</b>
5.1 Rekomandimet.....	40
<b>Aneksi 1: Kornizat e shqyrtuara ekzistuese të drejtësisë mjedisore dhe të drejtësisë gjinore .....</b>	<b>45</b>
<b>Aneksi 2: Informacione mbi intervistat me palët e interesit dhe punëtoritë e validimit .....</b>	<b>47</b>
Pjesëmarrësit në intervista dhe punëtoritë e validimit .....	47
Pyetje për intervistat me palët e interesit.....	47
Fotografi nga punëtoritë e validimit .....	Error! Bookmark not defined.
<b>Referencat.....</b>	<b>50</b>

# Akronimet

ACDC	Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike
BeH	Bosnjë dhe Hercegovinë
BeH SMPV 2030+	Strategjia Mjedisore dhe Plani i Veprimit për Bosnjë dhe Hercegovinën deri në vitin 2030
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
CBD	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DhSLK	Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
EKW	EcoKosWomen
BE	Bashkimi Evropian
FBeH	Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës
DhBGj	Dhuna në baza gjinore
GLPS	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IBCM	Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës
NAP BeH	Strategjia për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Zhvillimi me Emetime të Ulëta për Bosnjë dhe Hercegovinën
RS	Republika Srpska
SLAPP	Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike
UNCCD	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Shkretëtirimit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	Konventa Kornizë e Kombeve për Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

# Përmbledhje ekzekutive

Drejtësia mjedisore nuk mund të arrihet pa mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë gjinore. Trajtimi i pabarazisë gjinore është i nevojshëm pasi që paraqet pengesë për parimet themelore të drejtësisë mjedisore, duke përfshirë ndarjen e drejtë të përfitimeve dhe barrës mjedisore (drejtësia distributive); qasjen dhe ndikimin e barabartë në qeverisjen mjedisore (drejtësia përfaqësuese); dhe proceset për vendimmarrje mjedisore në formë transparente, të informuar dhe gjithëpërfshirëse (drejtësia procedurale). Ndikimet e degradimit mjedisor marrin formë nga pabarazitë gjinore, me gratë që përballen me dëmtime disproporcionale pa qasje të barabartë në resurse për t'i përballur në mënyrë efektive (Boyer dhe Granat, 2021; Castañeda Carney et al., 2020; OHCHR, 2022; UN Women, 2022). Teksa gratë po mobilizohen dhe udhëheqin përpjekjet për të trajtuar degradimin mjedisor, ato shpesh lihen jashtë hapësirave vendimmarrëse për adresimin e padrejtësive mjedisore, si dhe përballen me pengesa për qasje në drejtësi (Strumskyte et al., 2022; Tran dhe Hanaček, 2023; Xie, 2023).

Në Bosnjë dhe Hercegovinë (BeH) dhe Kosovë, drejtësia mjedisore dhe lidhjet që ajo ka me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave janë çështje me interes që po ngrihen mes vendimmarrësve, grupeve të avokimit dhe banorëve. Në shoqëritë pas konfliktit si BeH dhe Kosova, drejtësia mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore kontribuon në përpjekjet e rëndësishme për ndërtim të paqes dhe kohezion social të prioritzuara në dekadat pas konfliktit të dhunshëm. Gratë udhëheqëse, shoqëria civile dhe aktiviste në BeH dhe Kosovë zotërojnë potencial kritik për ta nxitur drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Megjithatë, për ta mundur drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore dhe për ta mbështetur rolin e grave në këto fusha, duhet të kuptohen dhe të adresohen pengesat strukturore, pabarazitë dhe kufizimet në kapacitete.

## Qëllimi

Ky studim paraqet një hap të parë në shqyrtimin kritik të drejtësisë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore nga zyrat e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në BeH dhe Kosovë. UNDP në BeH dhe UNDP në Kosovë e mundësuan zhvillimin e këtij studimi të përbashkët për t'i identifikuar mundësitë dhe sfidat për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore si një rrugë drejt paqes, duke e ngritur bazën e njohurive rreth këtyre temave në zhvillim dhe duke e rritur vetëdijësimin për këto çështje kritike.

Ky studim përdori qasje të hulumtimit cilësor të literaturës dhe intervista të thelluara me palë të interesit për të shqyrtuar dhe analizuar sa vijon:

- *Ndikimet diferenciale të degradimit të mjedisit*: Për të shqyrtuar sesi degradimi dhe ndotja mjedisore ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe burrat, veçanërisht ata që jetojnë në zona rurale ose më pak të zhvilluara, dhe për t'i eksploruar përvojat, pengesat dhe mundësitë në baza gjinore në lidhje me drejtësinë mjedisore.
- *Kornizat e politikave dhe ato institucionale*: Për t'i identifikuar politikat, strategjitë, institucionet qendrore dhe proceset ekzistuese mjedisore që mbështesin angazhimin e grave në drejtësinë mjedisore, si dhe për t'i vlerësuar boshllëqet në kornizën ligjore dhe të politikave së bashku me sjelljen dhe praktikën në lidhje me çështjet gjinore dhe drejtësinë mjedisore.
- *Rolet, aktivizmi dhe pjesëmarrja*: Për t'i analizuar rolet e dallueshme dhe aktivizmin e grave dhe burrave (në të gjithë diversitetin e tyre) në drejtësinë mjedisore, për t'i identifikuar pengesat për pjesëmarrjen e tyre, si dhe për të hetuar nëse gratë janë në ballë

të aktivizimit dhe avokimit mjedisor, duke përfshirë raste studimore të suksesshme të nismave të udhëhequra nga gratë ose me gratë në qendër.

- *Fuqizimi dhe kohezioni social:* Për ta eksploruar potencialin e grave aktiviste, lëvizjeve për të drejtat e grave dhe të vendimmarrësve për t'u angazhuar në drejtësinë mjedisore si një interes i përbashkët drejt kohezionit social, si dhe për t'i identifikuar fushat kyçe të intervenimit me rëndësi për përfitimet socio-ekonomike dhe paqëndrueset të fuqizimit të grave në drejtësi mjedisore për komunitetin e gjerë.
- *Analiza kontekstuale dhe krahasuese:* Për t'i identifikuar të përbashkëtat ndërmjet konteksteve të BeH dhe Kosovës dhe për t'i eksploruar mundësitë për ndarje të njohurive për ta kapërcyer boshllëkun e të dhënave në çështjet gjinore dhe drejtësinë mjedisore.
- *Rekomandime të zbatueshme:* Për të formuluar rekomandime të zbatueshme në nivele të politikave dhe programeve për adresimin e boshllëqeve të identifikuara, duke u fokusuar në rritjen e barazisë gjinore në drejtësinë mjedisore dhe duke siguruar që rolet dhe kontributet e grave të përfshihen në mënyrë efektive në infrastrukturat ekzistuese për paqe.

## Gjetjet kyçe

- *Vlerësimet dhe të dhënat për çështjet gjinore dhe mjedisore janë të pamjaftueshme ose jo të disponueshme.* Hulumtimet e disponueshme dhe pikëpamjet e palëve të interesit nga BeH dhe Kosova tregojnë se gratë, veçanërisht në zonat rurale, janë më të ekspozuara dhe më të cenueshme ndaj dëmeve mjedisore dhe kanë më pak qasje në resurse dhe shërbime për t'u përballur me dëmet dhe për t'iu përshtatur atyre. Megjithatë, shtrirja e plotë e ndikimeve mjedisore gjinore nuk dihet për shkak të mungesës së vlerësimeve, të dhënave, hulumtimeve dhe analizave formale si në BeH ashtu edhe në Kosovë. Kjo është një pengesë për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Shpërndarja e dëmeve dhe barrës mjedisore ndërmjet grave dhe burrave nuk është kuptuar plotësisht, çka nënkupton se politikat dhe investimet mjedisore nuk janë të informuara dhe gjithëpërfshirëse.
- *Ka përfaqësim të pabarabartë në hapësirat vendimmarrëse mjedisore dhe ligjet dhe politikat mjedisore janë neutrale në aspektin gjinor.* Si në BeH ashtu edhe në Kosovë, gratë janë të nënpërfaqësuara në hapësirat vendimmarrëse mjedisore në të gjitha nivelet dhe bien nën kuotat gjinore të mandatuara ligjërisht. Veç kësaj, shumica e ligjeve dhe politikave mjedisore në të dyja rastet nuk i njohin ndikimet, prioritetet, shqetësimet dhe njohuritë e ndryshme mjedisore të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre. Kjo është një pengesë për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore, pasi që programet, projektet dhe investimet e formuara nga ligjet dhe politikat nuk po i marrin plotësisht parasysh nevojat, prioritetet dhe njohuritë e të gjithë njerëzve.
- *Shoqëria civile mjedisore dhe gjinore dhe gratë aktiviste janë udhëheqëse dhe akterë të rëndësishëm në drejtësinë mjedisore, por ato përballen me pengesa për t'u angazhuar në qeverisjen mjedisore.* Pavarësisht roleve të tyre të rëndësishme, organizatat e shoqërisë civile përballen me sfida financimi dhe ndërveprim kuptimplotë të kufizuar me institucionet publike që e pengojnë ndikimin e tyre në qeverisjen mjedisore. Roli i rëndësishëm i aktivizimit të grave në veprimet mjedisore është theksuar veçanërisht në BeH, por këto gra gjithashtu përballen me kërcënime gjinore, stigma sociale, dhunë, lodhje emocionale dhe padi si kundërpërgjigje ndaj avokimit të tyre. Pengesat me të cilat përballen gratë në shoqërinë civile dhe hapësirat e avokimit janë padrejtësi përfaqësuese dhe sfida për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore.
- *Organizatave mjedisore të shoqërisë civile dhe institucioneve qendrore zyrtare u mungojnë kapacitetet për ndërlidhjet gjinore dhe mjedisore.* Si në BeH ashtu edhe në

Kosovë, intervistat me shoqërinë civile zbuluan se këto organizata kanë kapacitete të ulëta dhe baza të dobëta të njohurive rreth ndërlidhjeve gjinore dhe mjedisore. Kapaciteti i kufizuar për sa i përket çështjeve gjinore është një padrejtësi përfaqësuese dhe pengesë për drejtësinë mjedisore pasi që pikëpamjet, prioritetet, shqetësimet, zërat dhe udhëheqësia e grave nga komunitete të ndryshme mund të mos vlerësohen siç duhet në përpjekjet e shoqërisë civile.

- *Të drejtat procedurale mjedisore nuk zbatohen në mënyrë konsistente ose adekuate, dhe proceseve u mungojnë konsideratat gjinore.* Një padrejtësi e konsiderueshme procedurale dhe pengesë për drejtësinë mjedisore është se nuk zbatohen të drejtat e përshkruara në kornizat ligjore si në BeH ashtu edhe në Kosovë, duke i përfshirë të drejtat për informim, pjesëmarrjen e publikut dhe drejtësinë në vendimet mjedisore. Në mesin e komuniteteve dhe shoqërisë civile kjo ka krijuar mungesë të besimit se institucionet publike publike dhe të drejtësisë i respektojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe mjedisit. Këtyre proceseve shpesh u mungojnë konsideratat gjinore, duke rezultuar në marginalizimin dhe përjashtimin e mëtejshëm të grave në qeverisjen mjedisore.
- *Aktivizmi mjedisor mbështet ndërtimin e paqes dhe unifikimin.* Intervistat në BeH dhe Kosovë riafirmuan potencialin e drejtësisë mjedisore si një rrugë premtuese për nxitjen e unitetit dhe qëndrueshmërisë në shoqëritë pas konfliktit. Njohja e ndërlidhjeve midis mbrojtjes së mjedisit dhe ndërtimit të paqes në nivel lokal tregon një vetëdijesim në rritje për përfitimet më të gjera të drejtësisë mjedisore. E rëndësishme është se mund të forcohet roli i grave si aktiviste, udhëheqëse të komunitetit dhe ndërtuese të paqes për përpjekje më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për drejtësi mjedisore dhe tranzicionale.

## Rekomandime

Realizimi i përfitimeve të shumta dhe të përhapura të drejtësisë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore duhet të përfshijë njohjen dhe riparimin e pabarazive në shpërndarjen e dëmeve dhe përfitimeve mjedisore, fuqizimin e zërit dhe aftësisë për veprim të grave, forcimin e kornizës ligjore mjedisore me përgjegjshmëri gjinore dhe sigurimin që proceset procedurale mjedisore të jenë llogaridhënëse ndaj grave dhe burrave në komunitete (De Andrade Correa, 2022; Turquet et al., 2023).

Rekomandimet për zyrat e UNDP-së në BeH dhe Kosovë për t'i adresuar sfidat dhe për t'i shfrytëzuar mundësitë për drejtësi mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore përfshijnë veprimet e mëposhtme, të bazuara në qasjen e trefishtë të UNDP-së për drejtësinë mjedisore (UNDP, 2022).

### ***Krijimi i kornizave ligjore mundësuese***

- *Të realizohen, financohen dhe mbështeten analiza dhe mbledhje e të dhënave gjinore dhe mjedisore.* Këtu përfshihet puna e drejtpërdrejtë me organizatat e shoqërisë civile mjedisore dhe gjinore, ngritja e kapaciteteve të agjencive statistikore dhe institucioneve publike rreth ndërlidhjeve gjinore dhe mjedisore, dhe siguri që të dhënat dhe analizat gjinore dhe mjedisore të jenë të disponueshme për publikun.
- *Të harmonizohen ligjet dhe zotimet ndërkombëtare dhe lokale për barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe drejtësinë mjedisore.* Këtu përfshihet rritja e bashkëpunimit dhe kapaciteteve, angazhimi i grave dhe grupeve të shoqërisë civile me fokus në çështjet gjinore, si dhe rritja e vetëdijesimit për të drejtat dhe kornizat ligjore.
- *Të realizohet një vlerësim gjinor i legjislacionit mjedisor në Kosovë.* Kjo do të ndihmojë në identifikimin e pikave hyrëse për përmirësimin e kornizës ligjore dhe forcimin e zbatimit.

Procesi mund të informohet nga një nismë e fundit e UNDP-së në BeH për hartëzim të çështjeve gjinore në të dhënat dhe legjislacionin për ndryshimet klimatike, mjedisin dhe biodiversitetin (Eskić-Šihljak dhe Knežević, 2022).

- *Të integrohen kërcënimet, ndikimet dhe shqetësimet e diferencuara gjinore dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor (VNM).* Integrimi gjinor duhet të forcohet në udhëzimet dhe kërkesat për VNM si në BeH ashtu edhe në Kosovë për të siguruar që vendimet mjedisore të udhëhiqen nga një analizë e informuar dhe me gjithëpërfshirje gjinore.

### **Forcimi i institucioneve efektive dhe me qytetarin në qendër**

- *Të ngriten kapacitetet e shoqërisë civile mjedisore për çështjet gjinore dhe mjedisore, integrimi gjinor dhe qasjet me përgjegjshmëri gjinore.* Këtu përfshihen trajnime dhe punëtori të dedikuara për qasjet me përgjegjshmëri gjinore, krijimi i rrjeteve dhe grupeve punuese ndërmjet grupeve të shoqërisë civile gjinore dhe mjedisore, si dhe angazhimi i shoqërisë civile për të udhëhequr zhvillimin e kapaciteteve dhe ndarjen e njohurive.
- *Të zhvillohen nisma për financim që e mbështesin udhëheqësinë e grave në shoqërinë civile mjedisore.* Kjo kërkon zhvendosjen dhe rritjen e qasjes në burimet e financimit duke caktuar një buxhet të qartë për shoqërinë civile dhe duke krijuar burime dhe zotime të sigurta dhe afatgjata financimi.
- *Të përshkruhen qartë kërkesat dhe udhëzimet e donatorëve për financim për ta përmirësuar qasjen për organizatat e shoqërisë civile dhe për t'i zhvendosur strategjitë e financimit drejt fuqizimit dhe përfitimeve të drejtpërdrejta për shoqërinë civile dhe organizatat në nivel bazë.* Udhëzimi duhet të përfshijë një fokus të veçantë në përmirësimin e qasjes në financim për shoqërinë civile të fokusuar tek gratë, OJQ-të rurale dhe organizatat në nivel bazë që shpesh përballen me pengesa në informim dhe kapacitete për fondet e donatorëve.
- *Të përmirësohen mekanizmat koordinues ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve për drejtësi mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore.* Kjo mund të përfshijë koordinimin dhe ndarjen e njohurive ndërmjet organizatave rurale dhe urbane, si dhe bashkëpunimin ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike.
- *Të mbështeten gratë aktiviste përmes mjeteve ligjore, shërbimeve, resurseve dhe mjeteve financiare të synuara.* Këtu mund të përfshihet reforma ligjore për veprën penale të shpifjes kundër aktivisteve mjedisore, veçanërisht për kërcënimet gjinore dhe dhunën ndaj grave aktiviste, si dhe avokimi për mekanizma më të plotë të llogaridhënies dhe mbrojtja kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).

### **Rritja e qasjes në drejtësi dhe fuqizimi ligjor**

- *Të ngriten kapacitetet e sistemit gjyqësor për ligjet mjedisore dhe gjinore.* Këtu mund të përfshihet përfshirja e çështjeve gjinore dhe mjedisit në kurrikulën e arsimit dhe trajnimit ligjor, zhvillimi i trajnimeve me palët gjyqësore të interesit për ligjet mjedisore, trajnimi i punëtorëve juridikë dhe avokatëve në zonat rurale për ligjet gjinore dhe mjedisore, si dhe mundësimi i sesioneve mbi legjislacionin për barazi gjinore me profesionistë ligjorë mjedisorë.
- *Të ngriten kapacitetet e shoqërisë civile, organizatave në nivel bazë dhe aktivistëve për të pasur qasje në informacion dhe drejtësi për çështjet mjedisore.* Këtu mund të përfshihet krijimi i fondeve ligjore emergjente për organizatat në nivel bazë dhe gratë aktiviste, ofrimi i ndihmës juridike falas për çështjet mjedisore, vendosja e komunikimit të qartë dhe të

qashtëm dhe infrastrukturës digjitate për proceset dhe gjetjet e VNM-ve, si dhe fuqizimi i grupeve të shoqërisë civile për të shërbyer si ofrues të konsultimeve publike.

# 1 Hyrje

Drejtësia mjedisore nënkupton se të gjithë – përkundër gjinisë, racës, përkatësisë etnike ose të hyrave – kanë të drejtën për të njëjtat mbrojtje dhe përfitime mjedisore dhe përfshirje kuptimplotë në politikat dhe veprimet që i formësojnë komunitetet e tyre. Megjithatë, hulumtimet nga e gjithë bota tregojnë se kjo ndodh rrallë dhe ndikimet e degradimit mjedisor formësohen dhe përforcohen nga modelet e diskriminimit dhe pabarazive, duke i përfshirë ato në baza gjinore (Boyer dhe Granat, 2021; Castañeda Carney et al., 2020; OHCHR, 2022; UN Women, 2022). Në të njëjtën kohë, gratë po mobilizohen dhe po i udhëheqin përpjekjet për ta trajtuar degradimin mjedisor dhe pabarazinë, por ato shpesh lihen jashtë hapësirave vendimmarrëse dhe përballen me pengesa ndaj shërbimeve, resurseve dhe të drejtave të barabarta (Strumskyte et al., 2022; Tran dhe Hanaček, 2023; Xie, 2023). Drejtësia mjedisore nuk mund të arrihet pa mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë gjinore, duke përfshirë njohjen dhe riparimin e pabarazive, një kornizë ligjore mjedisore mundësuese dhe me përgjegjshmëri gjinore, përfaqësimin e zërave të grave dhe aftësive për veprim, si dhe procese të përforcuara procedurale dhe të llogaridhënies për mjedisin dhe drejtësinë gjinore (De Andrade Correa, 2022; Turquet et al., 2023).

Më e rëndësishmja është se drejtësia mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore mbështet kushtet e nevojshme dhe mjedisë mundësuese për rrugët drejt paqes dhe kohezionit social duke i trajtuar shkaqet rrënjësore të degradimit mjedisor, pabarazive dhe brishtësisë dhe konfliktit (Ben-Shmuel dhe Halle, 2023; Boyer et al., 2020; Ensor, 2022; Ong, 2017; UN Women, 2020). Për shoqëritë pas konfliktit që e kanë të vështirë ta arrijnë pajtimin dhe t'i zgjidhin ndasitë sociale, fuqizimi i grave dhe mbështetja e drejtësisë mjedisore drejt drejtësisë tranzicionale ka një potencial të jashtëzakonshëm për rritje të qëndrueshme dhe të barabartë (Ong, 2017). Çështjet mjedisore mund të ofrojnë një terren neutral për bashkëpunim dhe dialog ndërmjet komuniteteve që përndryshe mund të mbeten të ndara. Nismat mjedisore mund ta lehtësojnë ndërtimin e besimit dhe pajtimin duke u fokusuar në interesat e përbashkëta dhe mirëqenien kolektive të mjedisit dhe duke e nxitur bashkëjetesën harmonike dhe mbështetjen e ndërsjellë midis pjesëtarëve të komunitetit. Zërat dhe udhëheqësia e grave janë të fuqishme në hapësirat mjedisore dhe paqëndrueshme dhe komponent i domosdoshëm i një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut për procese më të forta dhe gjithëpërfshirëse (Haffejee, 2021; UNDP dhe UN Women, 2022). Për më tepër, angazhimi i komuniteteve të marginalizuara në proceset e vendimmarrjes mjedisore mund t'i fuqizojë ata dhe të sigurojë një ndjenjë pronësie dhe aftësie për veprim, gjë që është vendimtare për ndërtimin e paqes afatgjatë.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë (BeH) dhe Kosovë, drejtësia mjedisore dhe lidhjet që ajo ka me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave janë çështje me interes që po ngrihen mes vendimmarrësve, grupeve të avokimit dhe banorëve. Si në BeH ashtu edhe në Kosovë, mbështetja e drejtësisë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore përkrah edhe kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), duke i përfshirë të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe institucionet efektive. Veç kësaj, drejtësia mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore kontribuon në përpjekjet e rëndësishme për ndërtim të paqes dhe kohezion social të prioritzuara në dekadat pas konfliktit të dhunshëm dhe ndasive sociale. Gratë udhëheqëse, shoqëria civile dhe aktiviste në BeH dhe Kosovë zotërojnë potencial kritik për ta nxitur drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Megjithatë, për ta mundur drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore dhe për ta mbështetur rolin e grave në këto fusha, duhet të kuptohen dhe të adresohen pengesat strukturore, pabarazitë dhe kufizimet në kapacitete.

Në kuadër të projekteve “Shfrytëzimi i të Dhënave dhe Teknologjisë së Avancuar për Parashikim të Përmirësuar të Riskut të Krizave dhe Modelimin Social në Bosnjë dhe Hercegovinë” dhe “Dialogu Ndërmjet Komuniteteve në Kosovë”, financuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përmes Dritares për Financim të Qeverisjes, Ndërtimit të Paqes, Krizave dhe Ripërtrirjes, veçanërisht nën-dritares për Parandalimin e Konfliktëve dhe Mbajtjen e Paqes, UNDP në BeH dhe UNDP në Kosovë e mundësuan zhvillimin e këtij studimi të përbashkët për t’i identifikuar mundësitë dhe sfidat për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore si një rrugë drejt paqes.

Ky studim fokusohet në mundësitë dhe sfidat për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore në komunitetet në BeH dhe Kosovë, veçanërisht për gratë në zonat rurale ose më pak të zhvilluara. Ky studim synon të shqyrtojë dhe të analizojë me sa vijon:

- *Ndikimet diferenciale të degradimit të mjedisit*: Për të shqyrtuar sesi degradimi dhe ndotja mjedisore ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe burrat, veçanërisht ata që jetojnë në zona rurale ose më pak të zhvilluara, dhe për t’i eksploruar përvojat, pengesat dhe mundësitë në baza gjinore në lidhje me drejtësinë mjedisore.
- *Kornizat e politikave*: Për t’i identifikuar politikat, strategjitë dhe proceset ekzistuese mjedisore që mbështesin angazhimin e grave në drejtësinë mjedisore, si dhe për t’i vlerësuar boshllëqet në kornizën ligjore dhe të politikave së bashku me sjelljen dhe praktikatat në lidhje me çështjet gjinore dhe drejtësinë mjedisore.
- *Rolet, aktivizmi dhe pjesëmarrja*: Për t’i analizuar rolet e dallueshme dhe aktivizmin e grave dhe burrave (në të gjithë diversitetin e tyre) në drejtësinë mjedisore, për t’i identifikuar pengesat për pjesëmarrjen e tyre, si dhe për të hetuar nëse gratë janë në ballë të aktivizmit dhe avokimit mjedisor, duke përfshirë raste studimore të suksesshme të nismave të udhëhequra nga gratë ose me gratë në qendër.
- *Fuqizimi dhe kohezioni social*: Për ta eksploruar potencialin e grave aktiviste, lëvizjeve për të drejtat e grave dhe të vendimmarrësve për t’u angazhuar në drejtësinë mjedisore si një interes i përbashkët drejt kohezionit social, si dhe për t’i identifikuar fushat kyçe të intervenimit me rëndësi për përfitimet socio-ekonomike dhe paqëndrueset të fuqizimit të grave në drejtësi mjedisore për komunitetin e gjerë.
- *Analiza kontekstuale dhe krahasuese*: Për t’i identifikuar të përbashkëtat ndërmjet konteksteve të BeH dhe Kosovës dhe për t’i eksploruar mundësitë për ndarje të njohurive për ta kapërcyer boshllëkun e të dhënave në çështjet gjinore dhe në drejtësinë mjedisore.
- *Rekomandime të zbatueshme*: Për të formuluar rekomandime të zbatueshme në nivele të politikave dhe programeve për adresimin e boshllëqeve të identifikuara, duke u fokusuar në rritjen e barazisë gjinore në drejtësinë mjedisore dhe duke siguruar që rolet dhe kontributet e grave të përfshihen në mënyrë efektive në infrastrukturat ekzistuese për paqe.

Ky studim e paraqet një hap të parë në shqyrtimin kritik të drejtësisë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore në BeH dhe Kosovë dhe fokusohet në mbledhjen e informacionit të disponueshëm dhe ngritjen e bazës së njohurive rreth këtyre temave në zhvillim. Studimi do të shërbejë si një bazë për nisma më të gjera për ta rritur vetëdijësimin e publikut për çështjet mjedisore dhe për t’i fuqizuar komunitetet, veçanërisht gratë, për të avokuar për drejtësi mjedisore.

## 1.1 Fushëveprimi dhe përmbajtja e studimit

Hulumtimi për këtë studim u fokusua në gjendjen e angazhimit të grave dhe konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore në kontekstet e BeH dhe Kosovës. Seksioni 2 ofron një përmbledhje të

metodologjisë së përdorur për studimin, duke përfshirë një kornizë të hulumtimit për konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore. Seksionet 3 dhe 4 ndajnë gjetjet e studimit për BeH dhe Kosovën, përkatësisht, duke e organizuar informacionin në nënseksionet e mëposhtme për të elaboruar aspektet kyçe të drejtësisë mjedisore, si dhe duke i përfshirë kutitë për rastet nga BeH dhe Kosova, aty ku janë të disponueshme:

- *Konteksti gjinor*: Secili seksion hapet me një përmbledhje të shkurtër të çështjeve kryesore gjinore dhe kontekstit të bazuar në gjetjet nga shqyrtimi i literaturës. Kjo ndihmon në informimin se si padrejtësitë sociale, politike dhe ekonomike në baza gjinore janë të ndërthurura me padrejtësitë mjedisore, duke i përfshirë dëmet dhe përfitimet disproporcionale mjedisore, nënperfaqësimin në qeverisjen mjedisore dhe procedurat e paqasshme të drejtësisë.
- *Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor*: Ky nën-seksion i përshkruan gjetjet se si gratë dhe burrat ndikohen nga dëmet dhe degradimi mjedisor, përfshirë edhe atë nga zhvillimi i infrastrukturës.
- *Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave dhe konsideratat gjinore në qeverisjen mjedisore*: Ky nën-seksion i përshkruan gjetjet mbi pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen mjedisore, konsideratat gjinore në ligjet dhe politikat mjedisore, dhe angazhimin e grave në avokimin dhe aktivizmin mjedisor.
- *Drejtësia procedurale - Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore*: Ky nën-seksion i përshkruan proceset procedurale mjedisore të disponueshme në vend/territor, veçanërisht ato të informuara nga Konventa e Aarhus-it (OSBE, 2012), dhe masën në të cilën ato zbatohen, si dhe mënyrën se si reflektohen konsideratat gjinore në këto procese.

Seksioni 5 ofron përfundime rreth gjetjeve të studimit, duke e përfshirë çdo ngjashmëri ndërmjet rasteve në BeH dhe Kosovë. Ai gjithashtu ofron rekomandime të politikave dhe programimit për UNDP-në për ta forcuar angazhimin e grave në drejtësinë mjedisore në BeH dhe Kosovë bazuar në qasjen e trefishtë ndaj drejtësisë mjedisore të përcaktuar nga UNDP-ja (2022):

1. Krijimi i kornizave ligjore në nivel lokal dhe ndërkombëtar, duke aplikuar qasje inovative dhe të bazuara në të drejtat e njeriut për respektimin, mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave mjedisore.
2. Forcimi i institucioneve me qytetarin në qendër dhe i institucioneve efektive, veçanërisht e atyre që lidhen me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, për të siguruar që ato të jenë të qasshme për të gjitha popullatat dhe të jenë të pajisura për ta monitoruar, respektuar dhe zbatuar ligjin mjedisor dhe për t'i promovuar të drejtat mjedisore.
3. Rritja e qasjes në drejtësi dhe fuqizimi ligjor për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

## 2 Metodologjia

Metodat e hulumtimit cilësor të literaturës dhe intervistat me palët e interesit u përdorën për të gjeneruar informacion për angazhimin e grave dhe konsideratat gjinore në çështjet dhe përpjekjet e drejtësisë mjedisore në BeH dhe Kosovë. Shqyrtimi i literaturës identifikoi resurse nga institucionet, bota akademike dhe institucionet hulumtuese, organizatat vendore, organizatat ndërkombëtare, donatorët dhe institucione të tjera relevante, si informata për gjetjet e studimit, si dhe për ta identifikuar kornizën e hulumtimit. Konsulentët lokalë u koordinuan me UNDP-në për t'i identifikuar palët e interesit në BeH dhe Kosovë që janë të përfshirë me çështjet dhe përpjekjet e drejtësisë mjedisore dhe gjinore, si dhe kryen intervista të thelluara për të siguruar informata

për studimin. Veç kësaj, në secilin vend/territor u mbajt një punëtori validimi me grupe të palëve relevante të interesit për t'i shqyrtuar gjetjet e studimit dhe për të ofruar reagime dhe informacion shtesë për studimin.

## 2.1 Korniza e hulumtimit

Literatura e disponueshme për drejtësinë mjedisore priret ta përkufizojë atë sipas tre kategorive: drejtësia distributive, drejtësia procedurale dhe drejtësia e njohjes (Blue et al., 2020; Ong, 2017; Schlosberg, 2003; Steger, 2007). Megjithatë, hulumtimet për drejtësinë mjedisore ndërseksionale vënë në dukje se kjo kornizë konceptuale nuk i analizon në mënyrë adekuate mënyrat komplekse si ndërthuren karakteristikat e identitetit, si varfëria, raca, etnia, gjinia, indigjeniteti, moshë dhe paaftësia, për të prodhuar padrejtësi mjedisore dhe për të ndikuar në avokimin mjedisor në kontekste specifike (Amorim-Maia et al., 2022; Atapattu et al., 2021; Bell, 2016; González-Hidalgo et al., 2022; Parsons et al., 2021).

Kështu, korniza e hulumtimit për këtë studim bazohet në korniza të shumta që lidhen me drejtësinë mjedisore, drejtësinë dhe analizën gjinore, dhe ndërthurjet e këtyre çështjeve (shih Aneksin 1 për kornizat e shqyrtuara dhe Tabelën 1 për kornizën e hulumtimit për këtë studim). Kjo ndihmoi në strukturimin dhe drejtimin e hulumtimit dhe përcaktimin e aspekteve gjinore të drejtësisë mjedisore në kuadër të këtij studimi për t'i kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë për forcimin e angazhimit të grave në drejtësinë mjedisore në BeH dhe Kosovë.

**Tabela 1: Korniza e hulumtimit të studimit për angazhimin e grave dhe konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore**

Drejtësia mjedisore	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Drejtësia distributive</i>: Ndarja e drejtë e përfitimeve dhe ngarkesave mjedisore, përfshirë ato nga aktiviteti ekonomik.</li> <li>• <i>Drejtësia përfaqësuese</i>: Të gjithë qytetarët kanë qasje dhe ndikim në qeverisjen mjedisore në të gjitha nivelet, si dhe njihen identitetet, përvojat dhe format e tyre të ndryshme të njohurive.</li> <li>• <i>Drejtësia procedurale</i>: Proceset e vendimmarrjes mjedisore janë transparente, të informuara dhe gjithëpërfshirëse. Vendosen dhe zbatohen mekanizmat për ta mbështetur qasjen në informacionin mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore.</li> <li>• <i>Drejtësia ndërsektorale gjinore dhe sociale</i>: Padrejtësitë mjedisore janë të ndërthurura pazgjidhshmërisht me pabarazitë sociale, ekonomike dhe politike, duke përfshirë ato të bazuara në gjini, racë, etni, moshë, indigjenitet, aftësi të kufizuara dhe të hyra, dhe nuk mund të ndahen nga shfrytëzimi ekonomik, marginalizimi i grupeve shoqërore dhe vartësia gjinore.</li> </ul>	
Aspekti gjinor i drejtësisë mjedisore	Pyetjet e hulumtimit

<p><b><i>Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor</i></b>  Për shkak të pabarazive mbizotëruese gjinore dhe diskriminimit të bazuar në normat, rolet dhe besimet gjinore socio-kulturore, gratë pësojnë ndikime disproporcionale nga degradimi i mjedisit. Gratë prirën të zotërojnë më pak tokë dhe resurse dhe kanë më pak mundësi ekonomike sesa burrat, dhe amvisëritë me kryefamiljare gra kanë më shumë gjasa të jenë në zona të ndotura dhe të degraduara mjedisore. Këto pabarazi e rrisin cenueshmërinë dhe ekspozimin e grave dhe vajzave ndaj dëmeve mjedisore dhe në të njëjtën kohë ato kanë mundësi të kufizuara për të përfituar nga resurset dhe zhvillimi mjedisor. Njohja e këtyre ndikimeve dhe shqetësimeve gjinore është me rëndësi kritike për adresimin e padrejtësive distributive.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat janë ndikimet shëndetësore, në mjetet e jetesës dhe ato ekonomike që degradimi dhe ndotja e mjedisit kanë tek gratë, burrat, të rinjtë, personat që jetojnë në varfëri dhe grupet e tjera të marginalizuara shoqërore?</li> <li>• Cilat janë pabarazitë dhe diskriminimi në baza gjinore që ndikojnë në cenueshmërinë ndaj degradimit të mjedisit?</li> <li>• Cilat janë prioritetet, shqetësimet dhe pengesat e ndryshme për personat që jetojnë në zonat rurale dhe urbane?</li> </ul>
<p><b><i>Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave në qeverisjen mjedisore</i></b>  Këtu përfshihen vendimmarrja mjedisore, ligjet dhe politikat mjedisore dhe shoqëria civile mjedisore. Udhëheqësia dhe pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen mjedisore përmirëson politikat dhe veprimet gjithëpërfshirëse dhe efektive. Megjithatë, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe gjinia nuk merret parasysh në mënyrë adekuate në kornizën ligjore mjedisore. Veç kësaj, grupet dhe aktivistët e shoqërisë civile, duke i përfshirë ato të fokusuar në mjedis dhe barazi gjinore, përballen me sfida strukturore në lidhje me qeverisjen mjedisore, por luajnë role të rëndësishme në edukim, avokim dhe llogaridhënien e akterëve për abuzimet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut. Forcimi i angazhimit dhe zërit të grave në vendimmarrjen mjedisore, si dhe njohja e ndërlidhjeve gjinore dhe mjedisore, është me rëndësi kritike për adresimin e padrejtësive në përfaqësim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si përfaqësohen dhe angazhohen gratë në vendimmarrjen mjedisore në të gjitha nivelet?</li> <li>• Si përfshihen cenueshmëritë specifike gjinore dhe mundësitë për qëndrueshmëri mjedisore në ligjet, politikat dhe zotimet mjedisore?</li> <li>• Si dhe në çfarë mënyrash angazhohen gratë në organizatat mjedisore, avokimin në nivel bazë dhe aktivizëm?</li> <li>• Cilat janë pengesat për angazhimin e grave në avokimin dhe aktivizmin mjedisor?</li> <li>• A ka boshllëqe në kornizën ligjore dhe të politikave që lidhen me çështjet gjinore dhe drejtësinë mjedisore?</li> </ul>
<p><b><i>Drejtësia procedurale - Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore</i></b>  Tre shtyllat e Konventës së Aarhus-it që shërbejnë për të drejtat procedurale për drejtësinë mjedisore janë qasja në informacion, pjesëmarrja e publikut dhe qasja në drejtësi (OSBE, 2012). Arritja e këtyre të drejtave procedurale kërkon përfshirjen e të gjitha palëve të interesit dhe procese të qasshme që e nxisin përfshirjen dhe përfaqësimin. Megjithatë, pabarazitë dhe normat e bazuara në gjini e kufizojnë qasjen e grave në proceset pjesëmarrëse, informacionin dhe drejtësinë kur bëhet fjalë për çështjet mjedisore. Nevojat, prioritetet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me ndikimet mjedisore gjithashtu nuk merren parasysh në mënyrë adekuate në vlerësimet që janë pjesë e proceseve procedurale mjedisore. Këto pabarazi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat të drejta procedurale janë vendosur për të promovuar vendimmarrje mjedisore gjithëpërfshirëse, transparente dhe të informuar?</li> <li>• Cilat janë sfidat për zbatimin efektiv të proceseve dhe llogaridhënien për këto procese?</li> <li>• Si angazhohen aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile me proceset procedurale? Cilat janë pengesat ndaj angazhimit efektiv?</li> <li>• A ka pengesa specifike gjinore në proceset procedurale?</li> <li>• A i trajtojnë vlerësimet dhe studimet e ndikimit mjedisor cenueshmëritë, prioritetet dhe shqetësimet specifike gjinore?</li> </ul>

dhe boshllëqe në baza gjinore përfaqësojnë padrejtësi procedurale dhe pengesë për drejtësinë mjedisore.	
---	--

## 2.2 Intervistat me palët e interesit dhe punëtoritë e validimit

Në shkurt dhe mars 2024, konsulentët lokalë në BeH dhe Kosovë zhvilluan intervista me palët e interesit nga institucionet publike, me shoqërinë civile, me gratë aktiviste, me mediat dhe akterët tjerë kyç të përfshirë në çështjet e drejtësisë mjedisore dhe/ose gjinore. Veç kësaj, në maj 2024, gjetjet fillestare të studimit u prezantuan në punëtoritë e validimit në secilin vend/territor me palët relevante të interesit. Në punëtoritë e validimit morën pjesë disa nga palët e intervistuar të interesit, sipas disponueshmërisë, si dhe palë të tjera të interesit të identifikuara nga ekipi hulumtues. Gjithsej, studimi u konsultua me 65 palë të interesit (50 gra, 15 burra) në të dyja vendet/territoret - 32 persona (28 gra, 4 burra) në BeH dhe 33 persona (22 gra, 11 burra) në Kosovë. Shih Aneksin 2 për pyetjet e intervistës dhe fotografitë nga punëtoritë.

Gjetjet nga intervistat me palët e interesit dhe reagimet nga punëtoritë e validimit janë përfshirë së bashku me gjetjet e shqyrtimit të literaturës në seksionet 3 dhe 4, ndërsa rekomandimet në seksionin 5.

## 2.3 Kufizimet

### Numri i palëve të konsultuara të interesit

Është e rëndësishme të pranohet se numri i palëve të interesit të konsultuara për këtë studim është relativisht i ulët, gjë që ishte një shqetësim i shprehur në punëtorinë e validimit në BeH. Konsulentët lokalë zhvilluan një hartë të palëve të interesit të akterëve relevantë në hapësirat mjedisore dhe/ose të drejtësisë gjinore brenda BeH dhe Kosovës; megjithatë, afati kohor i studimit, kapaciteti i resurseve të konsulentëve, resurset nga hulumtimi dhe përgjigjet nga palët e interesit ishin faktorë kufizues për numrin e intervistave të kryera dhe pjesëmarrësve në punëtori.

Është gjithashtu kritike të theksohet se tema e drejtësisë mjedisore dhe lidhja e saj me drejtësinë gjinore dhe fuqizimin e grave janë fusha në zhvillim në të dyja vendet/territoret. Teksa disa palë të interesit ndjehen më rehat dhe më të sigurta kur flasin për këto çështje, ekipi hulumtues konstatoi se palët e tjera të interesit ishin të interesuara për temat, por nuk mendonin se ishin të përgatitura të angazhoheshin me këto tema përmes intervistave ose punëtorive. Megjithatë, bisedat e zhvilluara si pjesë e këtij studimi theksojnë se këto çështje janë relevante dhe kritike,

dhe shumë palë të interesit shprehën entuziazëm për ta vazhduar këtë punë. Ngritja e kapaciteteve dhe e besimit për këto çështje do të ndihmojë në bashkimin e më shumë personave për të vepruar për drejtësinë mjedisore dhe gjinore.

Për ta adresuar këtë kufizim, ekipi hulumtues synoi që ta përfshinte një grup të larmishëm të palëve të interesit si në intervista ashtu edhe në punëtori, si dhe i përdori gjetjet e shqyrtimit të literaturës për t'i vërtetuar pikat kyçe. Për të siguruar transparencë, studimi identifikon se nga vjen informacioni duke e mbrojtur identitetin e atyre që janë të përfshirë në proceset e konsultimit me palët e interesit. Hartëzimi i palëve të interesit i kryer nga konsulentët do të ndihmojë dhe do të vazhdojë të përmirësohet nga UNDP-ja në zbatimin e rekomandimeve të këtij studimi. UNDP-ja është gjithashtu e përkushtuar për ta vazhduar punën dhe për ta shfrytëzuar momentumin e këtij studimi.

## **Të dhëna sasiore për çështjet gjinore dhe mjedisore**

Të dhënat e besueshme, me cilësi të lartë dhe të përditësuara për ndërlidhjen gjinore dhe mjedisore janë jashtëzakonisht të kufizuara ose të padisponueshme në një shumicë dërrmuese të vendeve/territoreve dhe konteksteve, duke përfshirë edhe BeH dhe Kosovën. Kornizat kryesore të monitorimit të lidhura me mjedisin, duke i përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Kornizën Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Grupin Global të Treguesve të Ndryshimeve Klimatike, kanë boshllëqe të konsiderueshme gjinore. Treguesit shpesh nuk kanë optikë gjinore dhe nëse treguesit i mbulojnë shqetësimet gjinore-mjedisore, të dhënat gjinore janë pothuajse plotësisht të padisponueshme (IUCN, 2023). Mungesa e investimeve në mbledhjen dhe zbatimin e të dhënave gjinore është një pengesë e rëndësishme për hartimin dhe zbatimin efektiv të politikave në fushat mjedisore.

Të dhënat e kufizuara për këto çështje u sollën si shqetësim gjatë punëtorive dhe intervistave dhe janë një kufizim zakonisht i cituar nga shqyrtimi i literaturës. Mbështetja e mbledhjes së të dhënave sasiore për këto tema në BeH dhe Kosovë ishte përtej fushëveprimit të këtij studimi, por ekipi hulumtues e ka theksuar në rekomandime rëndësinë e mbylljes së këtij boshllëku përmes veprimeve të vazhdueshme.

## **Gjuha e hulumtimit dhe përkthimi**

Intervistat me palë të interesit dhe punëtoritë e validimit u zhvilluan në gjuhën zyrtare në të dyja vendet/territoret – boshnjakisht, serbisht dhe kroatish për BeH si dhe shqip dhe serbisht për Kosovën. Një pjesë e punëtorive të validimit u zhvilluan në anglisht nga konsulenti ndërkombëtar, me përkthim të ofruar për pjesëmarrësit. Gjetjet nga këto metoda duhej të përktheheshin në anglisht për këtë studim, gjë që bart potencial për përkthime të gabuara dhe keqkuptime të gjetjeve. Ekipi hulumtues e zbuti këtë risk duke punësuar konsulentë lokalë që i flasin rrjedhshëm gjuhët zyrtare të punës të secilit vend/territor dhe anglishten, si dhe duke e ndarë kohën e duhur për përkthimin e gjetjeve. Veç kësaj, me pëlqimin e palëve të interesit, intervistat u incizuan dhe konsulentët lokalë morën shënime të hollësishme për t'u siguruar që ato mund të shqyrtoheshin dhe ta ndihmonin përkthimin.

### 3 Bosnjë dhe Hercegovinë: Gjendja e angazhimit të grave dhe konsideratat gjinore në drejtësisë mjedisore

#### Konteksti dhe sfondi shkurtimisht: Bosnjë dhe Hercegovinë

Popullsia e BeH karakterizohet nga grupe të ndryshme etnike dhe fetare, me tre besime kryesore - Islami, Krishterimi Ortodoks dhe Katolicizmi - që korrespondojnë me tre grupet kryesore etnike: boshnjakët, serbët dhe kroatët, përkatësisht (Malcom et al., 2024). Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, udhëheqësit fetarë u rreshtuan me lëvizjet etnike nacionaliste, duke çuar në integrimin e identiteteve etnike dhe fetare me strukturat e partive politike. Ndërmjet viteve 1992-1995, elitat etno-nacionaliste zhvilluan konflikte të dhunshme dhe fushata të spastrimit etnik në përpjekje për t'i kontrolluar territoret (BTI, 2024a; Malcom et al., 2024). Marrëveshja e Përgjithshme Kornizë për Paqe e vitit 1995 (Marrëveshja e Paqes e Dejtonit) i dha fund Luftës së Bosnjës dhe krijoi dy entitete përgjegjëse për shumë funksione qeveritare brenda shtetit, Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (FBeH), me shumicë boshnjake dhe kroate, dhe Republikën Srpska (RS), me shumicë serbe, si dhe distriktin e Brçkos, i cili është një njësi administrative autonome nën sovranitetin e BeH. Kushtetuta e BeH (Aneksi IV i Marrëveshjes së Dejtonit) synojë të ishte një aranzhim kalimtar i fokusuar në përfundimin e luftës dhe jo një kornizë afatgjatë për funksionalitetin institucional (BTI, 2024a). Kjo ka kontribuar në një shtet shumë të decentralizuar me përgjegjësi administrative të fragmentuara në pesë nivele të qeverisjes (komunale, kantonale, entiteti, distrikti i Brçkos dhe nivelet shtetërore qendrore) (BTI, 2024a; Malcom et al., 2024). Në vitin 2008, BeH dhe Komisioni Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij e nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila vendosi detyrime për BeH për ta harmonizuar legjislacionin ekzistues dhe të ardhshëm me acquis të BE-së dhe për ta siguruar zbatimin e tij. Në vitin 2016, BeH ka aplikuar zyrtarisht për anëtarësim në BE dhe është njohur nga BE-ja si vend kandidat për anëtarësim që nga viti 2022.

#### 3.1 Konteksti gjinor

Sipas Barometrit të Barazisë Gjinore të Bosnjë dhe Hercegovinës, shumica e grave dhe burrave në BeH besojnë se barazia gjinore është përmirësuar dhe se pjesëmarrja më e madhe e grave do të çonte në barazi më të lartë dhe politika më të drejta në shoqëri (Šiljak dhe Đipa, 2024). Megjithatë, kjo mbështetje deklarative për barazinë gjinore nuk pasqyron dhe garanton barazi substanciale domosdoshmërisht. Normat, traditat dhe besimet diskriminuese gjinore i përforcojnë strukturat patriarkale në BeH dhe kontribuojnë në pabarazitë gjinore në shumë fusha të jetës për gratë në BeH, duke e përfshirë përfaqësimin politik dhe vendimmarrjen, angazhimin ekonomik dhe mbrojtjen sociale dhe kujdesin shëndetësor (Šiljak dhe Đipa, 2024). Këto pabarazi pasqyrohen në Raportin e fundit për Boshllëkun Gjinor Global 2023, ku BeH renditet në vendin e 86-të nga 146 vende, duke rënë me 13 vende që nga viti 2022 (WEF, 2023). Pabarazitë dhe boshllëqet gjinore komplikohen nga diskriminimet e ndërthurura për grupet e marginalizuara shoqërore dhe politike, duke përfshirë romët dhe personat LGBTI (Komisioni Evropian, 2023a; Miftari et al., 2021; UNDP, 2018).

#### Korniza ligjore dhe institucionale

Gjatë 20 viteve të fundit, BeH ka ndërmarrë hapa për të adresuar dhe për të bërë progres në barazinë gjinore në kornizat ligjore, strategjike dhe institucionale, duke e përfshirë përputhjen me standardet dhe marrëveshjet e BE-së për të drejtat themelore (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022; Miftari et al., 2021 Šiljak dhe Đipa, 2024). Në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, BeH i ka ratifikuar disa korniza kyçe, duke e përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit

ndaj Grave (CEDAW), Konventën e Këshillit të Evropës (Konventa e Stambollit) për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim, dhe Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 'Gratë, Paqja dhe Siguria' (RKSOKB 1325) (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022; Miftari et al., 2021). Për më tepër, në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në vitin 2008, BeH është zotuar që ta përafrojë legjislacionin e vet me acquis të BE-së, duke përfshirë legjislacionin gjinor dhe kundër diskriminimit të BE-së, çka është vendimtare për anëtarësimin e vendit në BE (Kapić dhe Ramić, 2023).

Dy ligjet kryesore që e trajtojnë barazinë gjinore në BeH janë Ligji për Ndalimin e Diskriminimit dhe Ligji për Barazinë Gjinore. Ligji për Ndalimin e Diskriminimit synon që t'i forcojë mekanizmat për luftimin e diskriminimit, duke e përfshirë atë në baza gjinore. Ligji për Barazinë Gjinore e përcakton dhe e ndalon diskriminimin në baza gjinore dhe e trajton barazinë gjinore në arsim, punësim, punë dhe qasje në resurse dhe shërbime. Ligji gjithashtu e parashikon që gratë duhet të përbëjnë të paktën 40% të përfaqësimit në organet e sektorit publik. Për ta mbështetur zbatimin e këtij ligji, është miratuar Plani i Veprimit Gjinor i BeH, i cili përditësohet periodikisht për t'i monitoruar dhe koordinuar aktivitetet. Agjencia e BeH për Barazinë Gjinore ka për detyrë që ta mbikëqyrë zbatimin e Planit të Veprimit Gjinor dhe të koordinojë me Qendrat Gjinore në nivel entiteti, të cilat gjithashtu i koordinojnë strategjitë specifike sektoriale dhe zhvillojnë plane lokale veprimi gjinor (Karađinović, 2021). Të dyja ligjet janë pjesërisht në përputhje me direktivat gjinore të BE-së (Kapić dhe Ramić, 2023). Megjithatë, mungon zbatimi dhe ligjet për mosdiskriminimin nuk zbatohen ose harmonizohen mjaftueshëm me Ligjin për Barazinë Gjinore (Komiteti CEDAW, 2019; Komisioni Evropian, 2023a; Karađinović, 2021). Harmonizimi i këtyre ligjeve me Ligjin për Barazinë Gjinore është esencial për mbikëqyrjen efektive dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare për barazinë gjinore, veçanërisht në procesin e integritimit në BE (Kapić dhe Ramić, 2023).

## **Përfaqësimi politik dhe vendimmarrja**

Gratë janë të nënpërfaqësuara në vendimmarrje në të gjitha nivelet për shkak të pritshmërive dhe stereotipeve socio-kulturore (Komisioni Evropian, 2022; Kadribašić et al., 2020; Miftari, 2019; Šiljak dhe Đipa, 2024). Gratë mbajnë vetëm 16.67% të vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të BeH, 26.53% të vendeve në Parlamentin e Federatës, 18% të të gjitha vendeve në Asamblenë Kombëtare të Republikës Srpska dhe 11% të pozitave ministrore (Šiljak dhe Đipa, 2024 WEF, 2023). Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuara në asambletë dhe këshillat lokale, dhe perceptimi për to është se u mungojnë shkathtësi politike dhe se bëhen joaktive sapo të zgjidhen (Hogić, 2021; Kadribašić et al., 2020). Qasja e kufizuar në informacion, duke përfshirë sistemet komplekse politike dhe zgjedhore, minon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në BeH (HLPF, 2023). Gratë në vendimmarrje politike u nënshtrohen stereotipeve gjinore dhe standardeve të dyfishta, duke përfshirë përballjen me kritika nëse tregojnë tipare të personalitetit dominues ose ndërmarrës, si dhe fokus publik në pamjen e tyre fizike dhe jetën personale dhe jo në veprimet e tyre (Šiljak dhe Đipa, 2024). Gratë në pozita vendimmarrëse gjithashtu përballen me dhunë dhe diskriminim që dekurajon pjesëmarrjen e tyre, minon autoritetin e tyre dhe kërcënon sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Një studim për gratë në politikë në BeH zbuloi se 60% e 83 pjesëmarrëseve kanë përjetuar një formë dhune gjatë rrjedhës së angazhimit të tyre në politikë, duke përfshirë abuzim verbal dhe emocional të drejtpërdrejtë dhe online (Miftari, 2019).

## Angazhimi ekonomik

Rreth 40.5% e grave marrin pjesë në fuqinë punëtore krahasuar me 60% të burrave (Agjencia për Statistikat e Bosnjë dhe Hercegovinës, 2024). Më shumë se 60% e grave të punësuar punojnë në sektorin e shërbimeve, i cili shpesh karakterizohet nga kushte të pasigurta të punës (Agjencia për Statistikat e Bosnjë dhe Hercegovinës, 2019). Burrat në komunitetet rurale kanë më shumë se dy herë më shumë gjasa të jenë në punë në krahasim me gratë në këto komunitete (Karadžinović, 2021), dhe gratë në zonat rurale janë më të cenueshme nga varfëria dhe kanë më pak qasje dhe kontroll mbi resurset, duke përfshirë tokën, pronën, resurset financiare, arsimin dhe teknologjinë (Miftari et al., 2021; UNDP, 2023).

Puna e kujdesit shihet si një detyrim gjinor dhe gratë shpenzojnë rreth 6-7 orë në ditë për detyra të papaguara krahasuar me rreth 4.5 orë të shpenzuara nga burrat, gjë që e kufizon qasjen e tyre në mundësitë për gjenerim të të hyrave (Šiljak dhe Đipa, 2024; UN Women, 2023). Zgjedhjet e karrierës së grave shpesh varen drejtpërdrejt nga cilësia e ekonomisë së kujdesit të ofruar në shoqëri (Šiljak dhe Đipa, 2024; UNDP dhe SDC, 2021), dhe shërbimet e pamjaftueshme sociale i kufizojnë opsionet e karrierës në dispozicion të grave, si dhe aftësinë e tyre për veprim në politikë dhe në jetën publike. Për më tepër, diskriminimi në baza gjinore në vendin e punës e bën të vështirë për gratë që t'i sigurojnë dhe t'i mbajnë vendet formale të punës dhe ato kanë më shumë gjasa të punojnë në sektorin informal (UNDP, 2023). Nën atë vetë-ushqyese dhe gratë që janë sigurueset kryesore të të hyrave në ekonomitë familjare janë veçanërisht të cenueshme ndaj këtyre rrethanave (HLPF, 2023). Sipas Barometrit të Barazisë Gjinore të Bosnjë dhe Hercegovinës, shumica e grave dhe burrave të anketuar u pajtuan se bizneset më të vogla familjare janë më të përshtatshme për gratë, pasi që këto struktura lejojnë më shumë kohë për kujdesin për familjen (Šiljak dhe Đipa, 2024). Megjithatë, gratë ndërmarrëse dhe pronare biznesi përballen me sfida për financimin dhe rritjen e bizneseve. Gratë kanë shumë më pak gjasa të kenë një llogari bankare në një institucion financiar formal sesa burrat (48% krahasuar me 67%), dhe është e vështirë për gratë të marrin kredi për shkak të normave të ulëta të pronësisë që mund të përdoren për kolateral (74% e pronave të banimit janë në pronësi vetëm të burrave), çka e pengon ndërmarrësinë e grave (Miftari et al., 2021; UNDP 2023).

## Dhuna në baza gjinore

Qasja e grave në mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor mbetet e pamjaftueshme, veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat rurale dhe gratë që janë pakica etnike, siç janë gratë rome (Miftari et al., 2021). Dhuna në baza gjinore (DhBGj) është një shqetësim kritik dhe e pengon barazinë gjinore në BeH. Një studim i OSBE-së i vitit 2019 për dhunën ndaj grave zbuloi se 48% e grave në BeH kanë përjetuar një formë abuzimi, duke e përfshirë dhunën nga partneri intim, dhunën nga jo-partneri, ndjekjen dhe ngacmimin seksual, që nga mosha 15 vjeçare (OSBE, 2019a). Megjithatë, kjo shifër ka të ngjarë të jetë një vlerësim konservativ i dhunës aktuale të përjetuar, pasi dhuna ndaj grave është nën-raportuar për shkak të frikës nga dhunuesi, procedurave të gjata gjyqësore, dënimeve të ulëta për kryesit, mosbesimit tek autoritetet dhe stigmës sociale (HRW, 2020; Šiljak dhe Đipa, 2024). Shërbimet për viktimat e DhBGj-së dhe dhunës në familje janë të nën-financuara dhe shpesh janë të paqasshme për personat që kanë nevojë për shërbime. Rreth 42% e grave të intervistuar në anketën e OSBE-së deklaruan se nuk dinë çfarë të bëjnë nëse përjetojnë dhunë dhe 37% nuk ishin në dijeni të ndonjë organizate mbështetëse (OSBE, 2019a). Në BeH, të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin (DhSLK), shumica e të cilëve janë gra, kanë mbrojtje ligjore dhe njohje të ndryshme sipas ligjit. Megjithatë, disa burime raportojnë se viktimat e DhSLK-së përballen me sfida për kompensimin dhe mbrojtjen e duhur, dhe shumë prej tyre janë në situata të vështira

ekonomike dhe jetojnë në zona rurale pa mbështetje shëndetësore dhe psikologjike të qasshme (Amnesty International, 2023; Global Survivors Fund, 2022).

## **3.2 Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor**

BeH përballet me disa sfida mjedisore dhe nxitës të degradimit, duke e përfshirë ndotjen e ajrit, kapacitetet e kufizuara për menaxhim të ujit dhe mbeturinave, shpyllëzimin dhe zhvillimin e shpejtë të infrastrukturës dhe ndërtimit. Ekonomia e BeH dhe nevojat për energji janë shumë të varura nga derivatet fosile. Kjo çon deri në ndotjen e ujit, tokës dhe ajrit në nivele të rrezikshme në BeH. Si rezultat, BeH ka një nga normat mesatare më të larta të vdekshmërisë nga ndotja e ajrit në botë (UNDP, 2023; OBSH, 2023). Sipas Barometrit Ballkanik, ndotja e ajrit u rendit si shqetësimi më i madh mjedisor për komunitetet në BeH (Barometri Ballkanik, 2023). Kjo mbështetje në derivatet fosile nënvizon nevojën për tranzicion drejt burimeve më të pastra të energjisë për ta zbutur degradimin e mjedisit.

### **Gratë dhe burrat ndikohen ndryshe nga degradimi mjedisor**

Gratë, personat që jetojnë në varfëri, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe fetare, dhe grupe të tjera të marginalizuara nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe politike në BeH kanë më shumë gjasa të vuajnë nga ndikimet e menjëhershme dhe afatgjata të shkaktuara nga degradimi mjedisor dhe kanë resurse të kufizuara për t'i përballuar dhe për t'u rimëkëmbur (GEF dhe UNDP, 2020; Lehtmetts, 2021; Strambo et al., 2021a; Banka Botërore, 2021). Kjo është pjesërisht për shkak të dallimeve gjinore në përdorimin e kohës, qasjen, asetet financiare dhe resurset sociale, dhe ndikimit të kufizuar në hapësirat e vendimmarrjes (Mujić et al., 2019; Strambo et al., 2021a), si dhe strategjive dhe planeve neutrale ose të verbra ndaj gjinisë. Për shembull, vërshimet e mëdha në vitin 2014 patën ndikime shkatërruese mbi gratë, sepse planet e shpëtimit dhe mbrojtjes nuk ishin të ndjeshme ndaj gjinisë (Mujić et al., 2019).

Një e intervistuar nga një OJQ mjedisore deklaroi se gratë mund të jenë më të cenueshme ndaj risqeve shëndetësore ose zhvendosjes nga operacionet e minierave për shkak të roleve në kujdestari dhe statusit të tyre socio-ekonomik. Një tjetër i intervistuar theksoi se pabarazitë në pronësinë dhe qasjen në resurse, me shumicën e tokës që zotërohet nga burrat, nënvizojnë normat patriarkale që rregullojnë shpërndarjen e resurseve dhe rezultojnë në shqetësime dhe ndikime të diferencuara gjinore nga degradimi mjedisor.

### **Ekzistojnë shqetësime të ndryshme mjedisore midis zonave rurale dhe urbane**

Komunitetet rurale që jetojnë pranë termocentraleve me qymyr vuajnë ndikime të drejtpërdrejta në shëndetin dhe mjetet e jetesës nga ndotja e ajrit dhe ujërat e ndotura industriale, dhe shumë prej tyre janë të detyruar të largohen nëse janë në gjendje ta bëjnë këtë ose vuajnë në kushte jo të shëndetshme nëse nuk janë në gjendje të largohen (UNEP, 2018). Përdorimi i druve të zjarrit për ngrohje është i zakonshëm në familjet e varfra dhe në zonat rurale në BeH, dhe meqenëse gratë marrin përgjegjësinë kryesore për detyrat shtëpiake, ato janë më të ekspozuara ndaj ndotjes së ajrit në ambiente të brendshme nga këto burime (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022; Strambo et al., 2021b).

Energjia hidrike është një burim më i qëndrueshëm i energjisë elektrike në krahasim me qymyrin, por këto termocentrale shpesh planifikohen ose ndërtohen në komunitete të cenueshme, shumë

në zonat rurale, dhe ndërtimi mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në natyrë, qasjen në resurse dhe mjetet e jetesës (CfE, 2022; GEF dhe UNDP, 2020; UNEP, 2018). Banorët dhe grupet e shoqërisë civile janë të shqetësuar për ndikimet mjedisore të hidrocentraleve të vogla, veçanërisht në ekosistemet e varura nga uji, dhe nuk pajtohen me prioritizimin e përfitimeve ekonomike mbi resurset natyrore dhe shëndetin mjedisor në komunitete, si dhe me devijimin e qasjes në ujë nga sektori bujqësor në këto komunitete (CfE, 2022; GEF dhe UNDP, 2020; Sher et al., 2024). Komunitetet rurale, grupet mjedisore dhe aktivistët kanë udhëhequr përpjekje për kundërshtim të hidrocentraleve të vogla në të gjithë BeH dhe kanë arritur një moment historik të rëndësishëm në vitin 2022 kur dhoma e ulët e parlamentit të FBeH votoi për ndryshimin e Ligjit për Energjinë Elektrike për të ndaluar ndërtimin e çdo hidrocentrali tjetër të vogël për shkak të shqetësimeve të krijuara (Kurtic, 2022). Sipas pjesëmarrësve në punëtorinë e validimit, ka një moratorium për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj të vegjël në të dy Entitetet.

Pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit theksuan se duhet të ketë më shumë përpjekje për të nxitur bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit midis komuniteteve rurale dhe urbane për t'i trajtuar sfidat e përbashkëta mjedisore. Megjithatë, infrastruktura e dobët dhe e pamjaftueshme e komunikimit në komunitetet rurale është një pengesë për bashkëpunim efektiv dhe është një sfidë për gratë në komunitetet rurale që të kenë qasje në informacionin esencial për çështjet mjedisore, resurset dhe mbështetjen.

### **Janë të kufizuara hulumtimet, të dhënat, vlerësimet dhe vetëdijesimi për ndikimet mjedisore të diferencuara gjinore**

Informacioni i disponueshëm nga shqyrtimi i literaturës për ndërlidhjet, shqetësimet dhe prioritetet gjinore dhe mjedisore në BeH, ishte i kufizuar. Teksa këto çështje janë diskutuar nga palët e interesit, detajet janë të kufizuara dhe mungesa e të dhënave dhe analizave u përmend si pengesë. Ekziston nevoja për ta mbushur boshllëkun në vlerësimet formale dhe për të siguruar që të mbështeten analizat gjinore për çështjet mjedisore për t'i informuar më mirë politikat dhe aktivitetet.

## **3.3 Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave dhe konsideratat gjinore në qeverisjen mjedisore**

### **3.3.1 Vendimmarrja mjedisore**

Struktura komplekse e vendimmarrjes në BeH është e pranishme në vendimmarrjen mjedisore dhe ka 14 ministri të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit me prioritete dhe juridiksione të ndryshme, ndonjëherë të mbivendosura, si dhe gjykata që ofrojnë mbikëqyrje të pavarur dhe vendime në çështjet mjedisore (shih Tabelën 2). Kjo çon në sfida në koordinimin, vendimmarrjen dhe zbatimin e politikave për mjedisin dhe ndryshimet klimatike në vend (Alibašić dhe Atkinson, 2023; Shabafrouz, 2024), çka ndërlikohet më tej nga mosmarrëveshjet, korrupsioni dhe përpjekjet për t'i minuar vendimet në nivel shtetëror (BTI, 2024a). Si një vend kandidat për në BE, BeH duhet të harmonizojë rregulloret për mbrojtjen e mjedisit me ato të BE-së, por struktura e fragmentuar administrative i sfidon përpjekjet e harmonizimit (Alibašić dhe Atkinson, 2023; Shabafrouz, 2024).

**Tabela 2: Institucionet kryesore të përfshira në vendimmarrjen mjedisore në BeH**

<b>Niveli shtetëror</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtetuta ia cakton juridiksionin parësor për çështjet mjedisore FBeH-së dhe RS-së, por Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike është e autorizuar t'i mbikëqyrë problemet dhe çështjet mjedisore dhe është përgjegjëse për përcaktimin e parimeve të përgjithshme dhe koordinimin e aktiviteteve dhe harmonizimin në nivel ndërkombëtar të planeve të institucioneve dhe institucioneve në nivel entiteti.</li> <li>• Agjencia për Statistikat e BeH dhe Ministria e Komunikacioneve dhe Transportit e BeH mbështesin mandatat mjedisore dhe vendimmarrjen.</li> <li>• Komiteti Drejtues Mjedisor Ndër-Entitete u krijua në 1998 nga FBeH dhe RS për t'i përmirësuar strategjitë dhe politikat e përbashkëta në menaxhimin mjedisor. Ekziston gjithashtu një Komision Këshillues Ndër-Entitete i Korporatës së Menaxhimit të Ujit.</li> <li>• Agjencia e BeH-së për Barazinë Gjinore kontribuon në drejtësinë mjedisore dhe gjinore përmes politikave për barazi gjinore dhe bashkëpunimit ndërsektorial, duke e përfshirë rolin e saj udhëheqës në Koalicionin Feminist për Drejtësi Klimatike në BeH.</li> </ul>
<b>Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës (FBeH)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria Federale e Mjedisit dhe Turizmit është përgjegjëse për strategjitë dhe politikat për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe dheut.</li> <li>• Vendimmarrjen mjedisore në entitet e mbështesin edhe Ministrinë e Ujërave, Bujqësisë dhe Pyjeve; Shëndetësisë, Energjisë, Minierave dhe Industrisë; Transportit dhe Komunikimeve, dhe ajo e Planifikimit Urban.</li> <li>• Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit të FBeH-së është i përfshirë në financimin e përgatitjes, zhvillimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve mjedisore dhe mbështet Ministrinë në përgatitjen e strategjive dhe planeve të veprimit.</li> <li>• Ministrinë e mjedisit të nivelit kantonal në FBeH luajnë një rol të ndërmjetëm përmes zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përshtatjes, integritit të objektivave zbutëse në planet e zhvillimit dhe efijencës së energjisë.</li> <li>• Komunat në FBeH luajnë një rol lokal përmes krijimit dhe zbatimit të politikave të mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të resurseve natyrore të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe menaxhimit dhe financimit të operacioneve, objekteve dhe parqeve.</li> </ul>
<b>Republika Srpska (RS)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Ekologjisë është përgjegjëse për strategjitë dhe zbatimin e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve mjedisore dhe bashkëpunimin me institucionet mjedisore ndërkombëtare dhe lokale.</li> <li>• Vendimmarrjen mjedisore në entitet e mbështesin edhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave; Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Energjisë dhe Minierave; Transportit dhe Komunikimeve; dhe ajo e Tregtisë dhe Turizmit.</li> <li>• Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Efijencën e Energjisë në RS është i përfshirë në mbledhjen e fondeve dhe financimin e përgatitjes, zhvillimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve mjedisore.</li> <li>• Njësitë administrative lokale në komuna luajnë një rol lokal duke garantuar ruajtjen e resurseve natyrore, monitorimin e cilësisë së ajrit, menaxhimin e resurseve ujore dhe zbatimin e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit.</li> </ul>
<b>Distrikti i Brçkos</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe Çështje Pronësore i Qeverisë së Distriktit të Brçkos është përgjegjës për kryerjen e detyrave profesionale dhe administrative që vlejné për mbrojtjen e mjedisit dhe eko-lejet.</li> </ul>

*Burimet:* Intervista me palë të interesit në BeH; Dietachmair et al. (2024); Komiteti Evropian i Rajoneve (n.d.); Agjencia Evropiane e Mjedisit (2021); Pilipović (2021)

## Gratë janë të nënpërfaqësuar në vendimmarrjen mjedisore në të gjitha nivelet

Një raport i fundit tregon se, në vitin 2022, vetëm 2 nga 13 ministritë përgjegjëse për sektorët e mjedisit, energjisë dhe bujqësisë udhëhiqeshin nga gra, dhe nga 29 menaxherët e departamenteve brenda këtyre ministrive, vetëm 4 ishin gra (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022). Në nivel lokal, palët e interesit theksuan se gratë janë të nënpërfaqësuar në agjencitë e menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse dhe në administrimin e menaxhimit të pyjeve. Kur u intervistua, Agjencia për Barazi Gjinore i njohu sfidat për ta garantuar pajtueshmërinë me legjislacionin për barazinë gjinore, i cili i përcakton kuotat për përfaqësimin e grave në qeverisjen mjedisore.

Gjetjet nga punëtorja e validimit tregojnë se ka një nivel të lartë të përfshirjes politike në emërimin e pozitave drejtuese, gjë që shpesh rezulton në neglizhimin e barazisë gjinore në përzgjedhjen e pozitave drejtuese. Pjesëmarrësit theksuan se rritja e numrit të grave në role vendimmarrëse nuk rezulton domosdoshmërisht në politika më gjithëpërfshirëse dhe të barabarta gjinore, si dhe që fokusi duhet të jetë sigurimi që të përfshihen interesat e grave dhe grupeve të marginalizuara dhe të synohet drejtësia sociale dhe jo vetëm kuotat numerike.

Intervistat me shoqërinë civile mjedisore dhe gra aktiviste tregojnë se proceset lokale të vendimmarrjes lidhur me çështjet mjedisore nuk kanë transparencë dhe nuk janë gjithëpërfshirëse, çka e kufizon ndikimin e grave në vendimmarrje. Rritja e angazhimit të komunitetit dhe pjesëmarrjes së publikut është esenciale për promovimin e angazhimit të grave në vendimmarrjen mjedisore. Punëtorja vuri në dukje se sulmet ndaj opinionëve të ndryshme dhe kritikave të politikave institucionale mund ta shuajnë debatin konstruktiv dhe inovacionin, duke prekur veçanërisht gratë dhe aktivistët e shoqërisë civile. Adresimi i këtyre pengesave kërkon krijimin e hapësirave gjithëpërfshirëse për dialog dhe vendimmarrje që marrin parasysh këndvështrimet e grave.

---

*“Gratë në shoqërinë tonë ende nuk e kanë një rol vendimtar. Gratë në pozita të pushtetit janë shpesh një zgjatim i patriarkatit. Por mundësia që ato të kenë fjalën e tyre është e rëndësishme sepse nuk ndodh shpesh.”*

*- Intervistë me një grua aktiviste nga një zonë urbane*

---

### 3.3.2 Ligjet dhe politikat mjedisore

Çështjet mjedisore janë nën juridiksionin e të dyja entiteteve, FBeH dhe RS, si dhe shpërndahen më tej në nivelin e komunave për RS dhe kantoneve dhe komunave për FBeH. Kjo do të thotë se ekzistojnë ligje dhe politika të ndryshme në nivel entiteti për shqetësimet dhe çështjet mjedisore (shih Tabelën 3). Sipas palëve të interesit, kjo mund të çojë në praktika menaxhimi të fragmentuara dhe jokonsistente. Për shembull, nuk ka një ligj për pyjet në FBeH dhe secili kanton ka ligjin e vet për pyjet. Në nivel shtetëror, ekzistojnë dokumente strategjike mjedisore që i drejtojnë politikat mjedisore, duke i përfshirë strategjitë, planet e veprimit dhe raportet e përgatitura në përputhje me angazhimin e BeH ndaj disa kornizave ndërkombëtare dhe rajonale që lidhen me mjedisin (shih Tabelën 3). Ka mungesa në zbatimin e ligjeve dhe politikave mjedisore, duke përfshirë për shkak të peizazhit të fragmentuar të politikave, kapaciteteve dhe

resurseve të kufizuara institucionale, mungesës së objektivave të qarta dhe mekanizmave monitorues dhe mungesës së përkushtimit dhe prioritizimit të çështjeve mjedisore.

<b>Tabela 3: Ligjet, politikat, strategjitë dhe zotimet mjedisore</b>	
<b>Niveli shtetëror</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjia Mjedisore dhe Plani i Veprimit për BeH deri në vitin 2030 (BeH SMPV 2030+)<sup>2</sup></li> <li>• Strategjia për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Zhvillim me Emetime të Ulëta për BeH (NAP BeH)</li> <li>• Plani Strategjik për Zhvillim Rural të BeH (2018-2021)</li> <li>• Strategjia Kornizë e Energjisë për BeH deri në vitin 2035</li> <li>• Zotimi ndaj Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe është ratifikuar Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit.</li> <li>• Zotimi ndaj Konventës së OKB-së për Diversitetin Biologjik (CBD) dhe Konventës së OKB-së për Luftimin e Shkretëtirëzimit (UNCCD)</li> <li>• Mbështetja për deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.</li> <li>• Nënshkruese e Konventës së Aarhus-it.</li> <li>• Plani i Veprimit Gjiner për BeH 2023-2027 përfshin një fushë prioritare për mbrojtjen e mjedisit dhe veprimin për klimën.</li> </ul>
<b>Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës (FBeH)</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 33/03)</li> <li>• Ligji për Koncesionet ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 40/02, 61/06)</li> <li>• Ligji për Ujërat ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 70/06)</li> <li>• Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 33/03)</li> <li>• Ligji për Energjinë Elektrike ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 66/13, 94/15 dhe 54/19)</li> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Ajrit ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 33/03)</li> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e FBeH", Nr. 33/03)</li> </ul>
<b>Republika Srpska (RS)</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 71/2012, 79/2015, 70/20)</li> <li>• Ligji për Koncesionet ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr.59/13, 16/18 dhe 70/20)</li> <li>• Ligji për Ujërat ("Gazeta Zyrtare e RS" Nr.50/06, 92/09, 121/12)</li> <li>• Ligji për Energjinë Elektrike ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 8/2008 - teksti i rishikuar dhe i reduktuar, 34/2009, 92/2009 dhe 1/2011)</li> <li>• Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 40/2013, 2/2015 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 106/2015 dhe 3/2016 – korrigjimi, 104/2018 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe 84 / 2019)</li> <li>• Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 63/21)</li> <li>• Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 46/17)</li> </ul>
<b>Distrikti i Brçkos</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e Distriktit të Brçkos", Nr. 01-02-32/09)</li> <li>• Ligji për Koncesionet e Distriktit të Brçkos ("Gazeta Zyrtare e Distriktit të Brçkos", Nr. 41/06, 19/07.02/08)</li> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Ujërave ("Gazeta Zyrtare e Distriktit të Brçkos", Nr. 25/04, 1/05 dhe 19/07)</li> <li>• Ligji për Energjinë Elektrike ("Gazeta Zyrtare e Distriktit të Brçkos", Nr. 36/04, 28/07, 61/10 dhe 4/13)</li> <li>• Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Distriktit të Brçkos", Nr. 29/08, 18/17, 48/18, 10/20, 29/20, 40/20)</li> </ul>

<sup>2</sup> Në kohën e shkrimit, SMPV 2030+ i BeH nuk është miratuar zyrtarisht.

*Burimet:* Intervista me palë të interesit në BeH; Dietachmair et al. (2024); Eskić-Pihljak dhe Knežević (2022); Pilipović (2021)

## **Gjinia nuk është e përfshirë në ligjet dhe strategjitë për mbrojtje të mjedisit**

Mbrojtja e mjedisit në BeH rregullohet nga ligjet e entiteteve. Megjithatë, komponenti gjinor nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në legjislacionin ekzistues (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022). Në nivel shtetëror, gjinia është e integruar në disa strategji, por në shkallë të ndryshme. Për shembull, NAP përfshin një seksion mbi barazinë gjinore për zbatimin e strategjisë, duke theksuar se një qasje e integritit gjinor do të ndihmojë në identifikimin e cenueshmërive dhe kapaciteteve për përshtatje dhe për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, gjinia nuk përfshihet në mënyrë specifike në rezultatet dhe masat e planifikuara për realizimin e strategjisë (UNDP dhe GEF, 2020).

Nga intervistat me përfaqësues të institucioneve publike në RS dhe FBeH u konstatua se ministrinë e mjedisit e pranojnë rëndësinë e barazisë gjinore, por nuk kishte informacion të disponueshëm për objektivat, prioritetet dhe veprimet specifike nga ministrinë në lidhje me barazinë gjinore. Një raport nga Zyra e Auditimit të institucionit në FBeH vuri në dukje mungesën e integritit gjinor në strategjitë dhe planet e veprimit në FBeH, duke treguar se vlerësimet e barazisë gjinore janë të pamjaftueshme dhe se të gjitha institucionet duhet të përgjigjen siç duhet për ta përmirësuar këtë fushë. Organet qeveritare në nivel shtetëror dhe entiteti, institucionet kantonale dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe entitetet juridike me autorizime publike dhe ato në pronësi shumicë nga shteti, janë të detyruara t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për zbatimin e dispozitave të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore në BeH dhe Planin e Veprimit Gjinor të BeH (Zyra e Auditimit të Institucioneve në FBeH, 2023).

Të intervistuarit dhe literatura e disponueshme citojnë disa faktorë që e kufizojnë integrimin gjinor në kornizat ligjore mjedisore dhe zbatimin efektiv të politikave mjedisore: (1) mungesa e të dhënave për çështjet gjinore dhe mjedisore; (2) vetëdijesim i ulët për rëndësinë e politikave mjedisore me ndjeshmëri gjinore; (3) përfshirje dhe konsultim joadekuat me grupet e cenueshme në zhvillimin e politikave; dhe (4) mungesa e vlerësimeve formale për ndikimin e gjinisë në mjedis (Alibašić dhe Atkinson, 2023; Komisioni Evropian, 2023a). Pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit theksuan se konteksti patriarkal në BeH ndikon në mënyrën se si perceptohen dhe trajtohen çështjet mjedisore, gjë që prek si gratë ashtu edhe burrat. Politikat efektive duhet të njohin dhe adresojnë këto dallime gjinore për të siguruar që strategjitë e menaxhimit mjedisor të jenë me ekuitet dhe të drejta nga pikëpamja shoqërore.

## **SMPV 2030+ paraqet një përmirësim në integrimin gjinor në strategjitë për mbrojtje të mjedisit**

Nisma e SMPV 2030+ zhvilloi një dokument gjithëpërfshirës në nivel shtetëror që përfshin një strategji mjedisore dhe plan veprimi për të gjithë vendin, që i mbulon të gjitha nivelet administrative në BeH dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në përfshirjen e gjinisë në mbrojtjen e mjedisit (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022; Karađinović, 2021). Konsideratat e barazisë gjinore dhe sociale janë të integruara në të gjithë strategjinë dhe në planet e veprimit për nivelet e shtetit dhe të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos. SMPV 2030+ trajton aspekte të cenueshmërisë gjinore ndaj dëmtimeve mjedisore, aspektet gjinore të reduktimit të varfërisë dhe përfshirjes së grave në vendimmarrje, çka ndihmon në ngritjen e konsideratave gjinore nga përfshirja vetëm e grave si palë të cenueshme në përmirësimin e rezultateve të mjeteve të jetesës dhe fuqizimin e grave si agjente të ndryshimit (Eskić-Pihljak dhe Knežević, 2022; Strambo dhe Solujić, 2023).

Më e rëndësishmja është se prioriteti 7.4 i strategjisë për përmirësimin e mjedisit dhe menaxhimit zotohet për një nivel të lartë të vetëdijesimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse, veçanërisht duke u fokusuar tek gratë, të rinjtë dhe grupet e cënueshme sociale. Kjo shtrihet në përfshirjen e grupeve të shoqërisë civile në hartimin e dokumenteve strategjike dhe ligjore, duke përfshirë vlerësimet e ndikimit mjedisor (VNM) dhe dhënien e lejeve mjedisore. Në prioritetin 7.6, përmendet përdorimi i mjeteve, të tilla si analiza gjinore, vlerësimi i ndikimit gjinor, buxhetimi me përgjegjshmëri gjinore dhe auditimet gjinore, në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe projekteve mjedisore për të siguruar që standardet dhe parimet e barazisë gjinore janë të integruara në politikat, strategjitë dhe programet mjedisore.

SMPV 2030+ është gjithashtu i rëndësishëm për inkurajimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërsektorial, pasi Agjencia e BIH për Barazinë Gjinore ka një rol në pronësinë dhe zbatimin e SMPV 2030+. Ky angazhim dhe rol i Agjencisë është inkorporuar në Planin e Veprimit Gjinor të zhvilluar rishtazi për BeH 2023-2027, i cili përfshin një fushë specifike prioritare lidhur me barazinë gjinore brenda kontekstit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Strategjia nënkupton që përpara miratimit të saj në nivel shtetëror, duhet të miratohen strategji për mbrojtjen e mjedisit për entitetet dhe distriktin e Brçkos. Strategjitë e entiteteve dhe strategjia e distriktit të Brçkos veç janë miratuar. Megjithatë, që nga momenti i shkrimit, dokumenti në nivel shtetëror ende nuk është miratuar.

### **3.3.3 Organizatat mjedisore, avokimi në nivel bazë dhe aktivizmi**

Grupet e shoqërisë civile mjedisore janë të përfshira në mënyrë aktive në qeverisjen mjedisore në BeH dhe kanë dhënë kontribute të rëndësishme për drejtësinë mjedisore nëpërmjet edukimit dhe fushatave për rritjen e vetëdijesimit dhe mbikëqyrjen e zotimeve dhe ndikimeve mjedisore të bëra nga institucionet publike dhe private.

### **Shoqëria civile mjedisore përballet me sfida ndaj angazhimit në qeverisjen mjedisore dhe barazinë gjinore**

Palët e interesit theksuan se organizatat e shoqërisë civile në përgjithësi përballesh me sfida të qëndrueshmërisë financiare në BeH dhe varen shumë nga mbështetja nga financimi i huaj (BTI, 2024a; Veljović, 2019). Një studim konstatoi se OJQ-të mjedisore në BeH marrin trajnime dhe ngritje të kapaciteteve nga donatorë ndërkombëtarë, por këta donatorë mund të mos i mbështesin fondacionet për rritjen e roleve dhe ndikimit të organizatave në qeverisjen mjedisore. Studimi deklaroi se shumë organizata mjedisore “luajnë (luajtën) një rol kalimtar në VNM dhe rrallëherë e angazhojnë (angazhuan) shtetin në një nivel më të lartë ose me ndonjë rregullsi” (Fagan dhe Sircar, 2010, f. 18).

Pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit vunë në dukje se një rritje e vlerave patriarkale në Evropë ka implikime në politikat mjedisore dhe barazinë gjinore në BeH dhe ka ndikuar në politikat e donatorëve, e cila ka gjasa ta rrezikojë funksionimin e organizatave mjedisore dhe me fokus gjinor nëpërmjet uljes së financimit për veprimet lokale. Ata theksuan se duhet të ketë një elaborim të qartë të politikave të donatorëve dhe strategjive të financimit për ta siguruar shpërndarjen efektive të resurseve dhe këto politika duhet të përshtaten për t'u fokusuar në një qasje nga poshtë lart përmes mbështetjes së komuniteteve lokale.

Një çështje e diskutuar në punëtorinë e validimit dhe në literaturë është se mbrojtja e mjedisit nuk promovohet apo priorizohet në agjendat politike, dhe organizatat mjedisore të shoqërisë civile kanë angazhim të kufizuar me vendimmarrësit (Veljović, 2019). Shoqëria civile mjedisore e intervistuar për këtë raport studimi përballet me vonesa burokratike, mungesë të mbështetjes qeveritare dhe taktika të frikësimit të përdorura nga ata që iu preken interesat e veta, duke i përfshirë Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) që i targetojnë aktivistët si burrat ashtu edhe gratë. Për më tepër, rolet e OJQ-ve dhe strukturave qeveritare në menaxhimin e mjedisit nuk janë të qarta dhe të kuptueshme gjerësisht, çka ndikon në koordinimin efektiv midis entiteteve.

Shumë nga aktet e shoqërisë civile të intervistuar për këtë studim janë fokusuar në çështjet dhe veprimet mjedisore, me konsiderata të kufizuara gjinore. Organizatat mjedisore në punëtorinë e validimit deklaruan se shoqërisë civile mjedisore i mungojnë njohuritë e mjaftueshme për barazinë gjinore. Vetëm një e intervistuar nga nisma feministe EkoFem, është fokusuar në mënyrë eksplicite në sfidat me të cilat përballet gratë në aktivizmin mjedisor, veçanërisht në lidhje me ndërtimin e besimit dhe pengesat infrastrukturore.

Kohët e fundit në BeH ka pasur përpjekje për ta kapërcyer boshllëkun midis akterëve mjedisorë në të gjitha nivelet dhe për ta inkurajuar bashkëpunimin, duke e përfshirë veprimin klimatik me drejtësi gjinore (shih Kutinë 1). Kjo mund të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve dhe rrjeteve ndërsektoriale për zhvillim të qëndrueshëm më efektiv dhe gjithëpërfshirës dhe veprim mjedisor.

#### **Kutia 1: Koalicioni Feminist për Drejtësi Klimatike në BeH**

Në vitin 2022 u krijua Koalicioni Feminist për Drejtësi Klimatike në BeH për të përshpejtuar përparimin në veprimin klimatik me drejtësi gjinore. Koalicioni u krijua si pjesë e nismës globale “Barazia e Gjeneratave” nga UN Women në bashkëpunim me UNDP-në në BeH. Koalicioni mbledh së bashku përfaqësues nga qeveritë, shoqëria civile, organizatat rinore, organizatat ndërkombëtare dhe sektori privat për të trajtuar çështje kritike klimatike - gjinore dhe për t’i fuqizuar gratë në veprimin për ndryshimet klimatike. Një prioritet kyç i Koalicionit është ta mbështesë një tranzicion drejt një ekonomie të gjelbër gjithëpërfshirëse dhe rigjeneruese duke e promovuar qasjen e grave në financa për zgjidhjet klimatike, forcimin e pjesëmarrjes së grave në qeverisjen mjedisore dhe ekonomitë e gjelbra, ndërtimin e modeleve të bashkëpunimit të bazuara në komunitet, si dhe forcimin e mbledhjes dhe disponueshmërisë së të dhënave gjinore dhe mjedisore.

#### **Gratë angazhohen në shoqërinë civile mjedisore, por priren të jenë të nënpërfaqësuar në rolet udhëheqëse dhe vendimmarrëse**

Për sa i përket angazhimit të grave në shoqërinë civile mjedisore, disa të intervistuar sugjeruan se gratë janë më të angazhuara në aktivizmin mjedisor sesa burrat, veçanërisht gratë e moshuara dhe pensionistet sepse kanë më shumë kohë të lirë dhe më pak përgjegjësi shtëpiake në krahasim me gratë më të reja. Megjithatë, rolet drejtuese në organizatat mjedisore priren të dominohen nga burrat; sipas një grupi, kjo është për shkak të kufizimeve kohore të grave në lidhje me përgjegjësitë e përditshme dhe pengesat sociale për këto pozita. EkoFem gjithashtu vuri në dukje se ekziston një tendencë që gratë të largohen nga aktivizmi kur burrat i marrin rolet udhëheqëse, duke i theksuar dinamikat gjinore brenda lëvizjeve. Disa nga shoqëria civile mjedisore i vunë në dukje përpjekjet për ta përmirësuar pjesëmarrjen e grave. Për shembull, Eko BeH e zbaton heqjen e tarifave të anëtarësimit për grupe të caktuara për ta inkurajuar diversitetin në anëtarësi dhe pozitat drejtuese, dhe CZSS i mundëson takimet me eko-feministet për t’i angazhuar në përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit.

## Gratë kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në aktivizmin dhe avokimin mjedisor

Në intervistat me institucionet publike, shoqërinë civile mjedisore dhe gra aktiviste u lavdërua aktivizmi i grave në mbrojtjen e mjedisit, duke e theksuar kontributin e tyre të rëndësishëm, udhëheqësinë dhe qëndrueshmërinë pavarësisht përballjes me frikësime, kërcënime ligjore dhe stigmë shoqërore (shih Kutinë 2). Gratë përshkruhen si katalizatorë për mobilizimin e komunitetit dhe agjente të ndryshimit në avokimin për drejtësi mjedisore. Në një intervistë me një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit të FBeH-së, u vu re se gratë përfaqësohen dukshëm në media në lidhje me aktivizmin mjedisor dhe se shumë nisma për mbrojtjen e mjedisit burojnë nga gratë aktiviste.

---

*"Ne gratë veprojmë, duke e dhënë një shembull të mirë për gratë e tjera, veçanërisht kur vijmë nga një komunitet i vogël si ato vetë, duke i kaluar të njëjtat përvoja dhe të kuptuarit e tyre të njëjtë".*

*- Intervistë me një grua aktiviste nga një zonë urbane*

---

### Kutia 2: Gratë trime të Krushçicës

Në vitin 2017, gratë lokale kaluan më shumë se 500 ditë në akomodime të improvizuara për ta parandaluar ndërtimin e një hidrocentrali të vogël në lumin Krushçica (Kurtic, 2022). Komunitetet lokale thanë se nuk u konsultuan për hidrocentralin e planifikuar dhe u përgjigjën duke e bllokuar një urë që përdoret për qasje në vendpunishte. Gratë e përfshira në protestë u ndeshën me kundërshtime të dhunshme nga policia dhe u përballën me ofendime me konotacione seksuale, lëndime dhe arrestime, por ato u kthyen dhe vazhduan të protestonin në urë, e cila u riemërua nga vendasit në "Ura e Grave Trime të Krushçicës". (Arnika, 2019). Një urdhër gjykatë anuloi lejet për projektet e hidrocentraleve, por protestuesit vazhdojnë të përballen me beteja ligjore mbi koncesionet për projekte (Murphy, 2020). Disa gra të përfshira kandiduan dhe u zgjodhën në këshillin lokal, me disa burime që e raportuan këtë si hera e parë që gratë kishin fituar ulëse në këshillin lokal boshnjak (NDI, 2023a).

Gratë aktiviste theksuan motive të ndryshme për përfshirjen e tyre në përpjekjet për drejtësi mjedisore, duke e përfshirë shqetësimin për shëndetin e fëmijëve dhe komunitetit të tyre, ndjenjën e solidaritetit dhe mbështetjen e komunitetit në aktivizëm, mbrojtjen e resurseve natyrore dhe mjedisit lokal, si dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe traditave të lidhura me natyrën dhe resurset natyrore. Ato janë gjithashtu të përkushtuara për të luftuar kundër padrejtësisë dhe korrupsionit politik që kontribuojnë në çështjet mjedisore. Këto motive shpesh lidhen me përvojat individuale, ndjenjën e përgjegjësisë ndaj gjeneratave të ardhshme dhe dëshirës për ta ruajtur mjedisin natyror për gjeneratat e ardhshme.

---

*"Sa i përket motivimit tim, ka të bëjë me shëndetin tonë dhe të fëmijëve tanë, ruajtjen e trashëgimisë sonë. Lumi rrjedh para shtëpisë sime. Prindërit e mi janë varrosur atje. Ky është motivimi im. Jam e lidhur emocionalisht me vendlindjen time."*

## **Gratë në aktivizmin mjedisor përballen me pengesa gjinore dhe risqe**

Të intervistuarit treguan se gratë në aktivizmin mjedisor përballen me pengesa dhe risqe specifike bazuar në gjininë e tyre, duke përfshirë dhunën, sulmet verbale, kërcënimet dhe rraskapitjen emocionale. Si gratë ashtu edhe burrat në pozita të aktivizmit shpesh përballen me padi, veçanërisht SLAPP që përdoren nga investitorë të fuqishëm për t'i bërë të heshtin zërat kundërshtues, por gratë aktiviste mund të kenë më pak resurse financiare dhe ligjore për të luftuar kundër padive. Një e intervistuar vuri në dukje se gratë mund të përballen me risqe më të larta të padive në krahasim me burrat dhe reflektoi për një padi kundër Hajrija Çobo, një grua mbrojtëse e të drejtave mjedisore, duke e pyetur veten nëse padia do të kishte ndodhur edhe nëse Çobo do të ishte burrë. Një i intervistuar shpjegoi se akterët e fuqishëm përdorin resurse për të përfituar benefite me komunitete, ndërkohë që i frikësojnë aktivistët.

---

*“Aktivistët definitivisht janë duke u frikësuar. E kam pasur një përvojë të ngjashme me komentet online. Korporatat kanë mekanizma të zhvilluar mirë për t'i frikësuar aktivistët, ndërsa, nga ana tjetër, u dhurojnë televizorë shkollave, i asfaltojnë rrugët, e kështu me radhë.”*

- Intervistë me një grua aktiviste nga një zonë urbane

---

Intervistat zbuluan se ka faktorë që mund ta kufizojnë angazhimin e grave në nismat për drejtësi mjedisore dhe hapësirat e aktivizmit. Për shembull, normat dhe pritshmëritë shoqërore i pengojnë veçanërisht gratë në zonat rurale nga përfshirja në nisma dhe aktivizëm në nivel bazë për shkak të përgjegjësive konkurruese ditore dhe resurseve të kufizuara financiare. Në zonat rurale, gratë gjithashtu kanë më pak qasje në informacion, grupe mjedisore dhe resurse që mund të ndihmojnë në mbështetjen e aktivizmit të tyre. Shumë gra aktiviste thanë se komunitetet e tyre shpesh e mbështesin aktivizmin e tyre, por ka raste kur banorët mund të jenë agresivë dhe t'i akuzojnë se po e kundërshtojnë zhvillimin. EkoFem dhe gratë aktiviste e theksuan gjithashtu rëndësinë e mbështetjes së shëndetit psikologjik dhe mendor për gratë në aktivizëm për ta trajtuar lodhjen e madhe emocionale prej aktivizmit mjedisor dhe reagimin gjinor me të cilin përballen këto gra.

---

*“Në nivel lokal, është jashtëzakonisht rraskapitëse ta drejtosh luftën. Gratë e Krushçicës edhe sot emocionohen shumë kur i kujtojnë përjetimet e tyre. Njerëzit u ndanë edhe në mes vete për këtë çështje. Familjet pothuajse u ndanë mes atyre pro dhe kundër. Tradhtitë ishin të thella. Mbështetja psikologjike doli natyrshëm si temë”.*

- Intervistë me një grua aktiviste

---

## Aktivizmi mjedisor mbështet ndërtimin e paqes dhe unifikimin

Të gjithë personat e intervistuar për këtë studim deklaruan se mbrojtja e mjedisit dhe aktivizmi i bashkojnë njerëzit rreth një qëllimi të përbashkët, pavarësisht dallimeve etnike, fetare apo të tjera. I intervistuari nga ministria e mjedisit të FBeH-së pranoi se ambientalizmi i kapërcen kufijtë lokalë dhe kufijtë tjerë dhe sugjeroi se duhet bërë më shumë përpjekje për t'i bashkuar komunitetet e ndryshme në BeH në ambientalizëm për ta nxitur bashkëpunimin dhe solidaritetin gjithëpërfshirës. Kjo u pasqyrua në intervistat me shoqërinë civile dhe aktivistë, të cilët përmendën se nismat e suksesshme që i sfidojnë kërcënimet mjedisore janë udhëhequr nga gratë dhe përfshijnë bashkëpunim ndërmjet linjave etnike, dhe se lidhjet ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe ndërtimit të paqes vlerësohen në nivel lokal. Një grua aktiviste në zonën multietnike të Kakanjtit tha se lufta kundër hidrocentraleve të vogla dhe ruajtja e natyrës është një qëllim i përbashkët që i bashkoi njerëzit nga grupet e ndryshme etnike në mbrojtjen e mjedisit. Veç kësaj, u vu në pah komuna e Jezeros për aktivizmin e grave pavarësisht përballjes me sfida në një mjedis të ngarkuar politikisht dhe etnikisht të ndryshëm.

---

*“Është një gjë e bukur; njerëzit po bashkohen pa marrë parasysh gjithçka. Ne kemi gra udhëheqëse dhe burra që e mbështesin njëri-tjetrin... Ne nuk ua lejojmë njerëzve që të ndahen. Komuniteti i Lopares është mjaft nacionalist, por kolegu ynë shkoi për t'i regjistruar deklaratat e njerëzve atje që flisnin kundër ndasive. Qëndrimi është mbrojtja e resurseve natyrore, mjedisit, gjë që duhet të mbështetet pavarësisht çdo gjëje. Kjo është mbi të gjitha”.*

*- Intervistë me një OJQ mjedisore*

---

## 3.4 Drejtësia procedurale - Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore

BeH është nënshkruese e Konventës së Aarhus-it dhe zbatimi i saj mbikëqyret nga Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit i Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të BeH. Në vitin 2013, nga OSBE-ja u krijua një rrjet prej katër qendrash të Aarhus-it për ta mundësuar qasjen e banorëve në informacion, për ta mbështetur përfshirjen në vendimmarrjen mjedisore, si dhe për të ofruar mbështetje për mbrojtjen ligjore të të drejtave të njeriut në mjedis (OSBE, n.d.).

Ligjet si në FBeH ashtu edhe në RS u përmbahen gjerësisht dispozitave të Konventës së Aarhus-it dhe i mbështesin të drejtat procedurale në vendimmarrjen mjedisore dhe plotësim-ndryshimet e fundit e kanë forcuar përputhshmërinë me konventën. Për tre të drejtat procedurale sipas konventës, janë në zbatim proceset e mëposhtme (Pilipović, 2021):

- Qasja në informacionin mjedisor mbështetet përmes ligjeve për lirinë e qasjes në informacion dhe ligjeve për mbrojtjen e mjedisit në të dyja entitetet dhe në distriktin e Brçkos. Kur paraqitet një kërkesë për informacion, inicohet një procedurë administrative për dhënie të informacionit sipas afateve në varësi të dispozitave specifike. Afatet ia lejojnë kërkuarit që të ketë qasje në të drejtën e vet për drejtësi nëse kërkesa refuzohet ose përgjigja është e pakënaqshme. Procedurat për kontestet administrative mbulohen në ligjet për kontestet administrative për të dyja entitetet dhe distriktin e Brçkos.

- Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore zbatohet nga institucionet sipas ligjeve për mbrojtjen e mjedisit në entitete dhe distrikt, dhe pjesëmarrja e publikut parashikohet në fazat fillestare të VNM-ve dhe në procesin e miratimit të Vlerësimeve.
- Për qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore ekzistojnë disa rregullore që e lejojnë fillimin e kontesteve në kërkesat për informacion, miratimin e studimeve të ndikimit mjedor ose lëshimin e lejeve mjedisore. Qasja në drejtësi mund të iniciohet përmes kontesteve administrative ose kundër vendimeve të gjykatave që vendosin për një kontest administrativ.
- VNM-të dhe lejet mjedisore rregullohen përmes ligjeve për mbrojtjen e mjedisit në të dyja entitetet dhe në distriktin e Brçkos. Rregullat për VNM-të siç përkruhen në Direktivën e BE-së për VNM janë transpozuar dhe proceset për VNM-të janë vendosur në të dyja entitetet dhe në distriktin e Brçkos (Havránková, 2016).

Përfaqësuesit nga Ministria e RS për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Ekologji e interpretojnë drejtësinë mjedisore përmes këtyre proceseve procedurale, duke e theksuar barazinë në zbatimin e rregulloreve dhe qasjen në drejtësi. Përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit të FBeH e theksuan gjithashtu rëndësinë e proceseve procedurale në drejtësinë mjedisore dhe deklaruan se ka mundësi për reagime për nismat nga shoqëria civile dhe konsultimet publike dhe programet e edukimit për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe grupeve të cënueshme në proceset e vendimmarrjes.

### **Mungon vënia në praktikë dhe zbatimi i të drejtave procedurale**

Megjithatë, gjetjet nga intervistat dhe raportet tregojnë se prania e plotësim-ndryshimeve dhe ligjeve për proceset e drejtësisë mjedisore nuk janë domosdoshmërisht tregues të zbatimit në praktikë. Përkundër detyrimeve ligjore, VNM-të nuk përgatiten në mënyrë të vazhdueshme dhe planifikimi vazhdon të kryhet pa konsultimin e palëve të interesit, duke çuar në protesta dhe sfida në gjykatë (Komisioni Evropian, 2023a). Një raport i zbatimit në hije për Konventën e Aarhus-it i dorëzuar nga Arnika, Qendra për Mjedisin dhe shoqata Qendra e Resurseve Aarhus në vitin 2021, i përshkruan sfidat për zbatimin, duke e përfshirë mungesën e kapaciteteve të entiteteve shtetërore në procedurat për ndarje të informacionit, publikimin joadekuat të proceseve të auditimit publik, dhe procedimet e zgjatura gjyqësore dhe administrative, si dhe mungesën e koordinimit ndërmjet niveleve të ndryshme të institucioneve (Pilipović, 2021).

Palët e interesit vunë në pah se ka një numër të pamjaftueshëm të juristëve mjedisorë, gjë që i përkeqëson sfidat për t'i adresuar çështjet mjedisore në gjykata. Për më tepër, ka një interes të ulët mes juristëve për të përfaqësuar rastet mjedisore në komunitetet rurale për shkak të potencialit të ulët të fitimit dhe kohëzgjatjes së përpunimit. Kjo është një pengesë e rëndësishme për drejtësinë mjedisore.

Intervistat me palët e interesit i ndanë gjithashtu shqetësimet aktuale rreth plotësim-ndryshimeve të propozuara në Ligjin për Hulumtimet Gjeologjike në RS, i cili do t'i hiqte dispozitat që kërkojnë studime të ndikimit mjedor dhe miratim nga banorët që kompanitë të kryejnë hulumtime gjeologjike në vende të caktuara. Këto ndryshime do t'i pengonin proceset procedurale në përputhje me Konventën e Aarhus-it dhe do ta kufizonin aftësinë e banorëve dhe shoqërisë civile për të ngritur shqetësime dhe për të kërkuar drejtësi për dëmtimet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut.

## **Ekziston një nivel i lartë mosbesimi se entitetet publike i mbrojnë të drejtat mjedisore dhe ato të njeriut**

Intervistat me shoqërinë civile dhe aktivistë zbulojnë një temë të përbashkët të mosbesimit se entitetet publike, duke i përfshirë gjykatat, policinë dhe institucionet e tjera qeveritare, i respektojnë procedurat e drejtësisë dhe i trajtojnë në mënyrë efektive shqetësimet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut. Ekziston shqetësimi se aktivitetet e sektorit publik dhe privat mund të mos jenë llogaridhënëse në mënyrë adekuate për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e komunitetit. Të intervistuarit deklaruan se pa besim në këto entitete, arritja e drejtësisë procedurale është sfiduese dhe komunitetet mund të hezitojnë të angazhohen me mekanizma ligjorë për t'i adresuar ankesat. Për më tepër, mungesa e besimit dhe llogaridhënies çon në padrejtësi mjedisore, ku komunitetet e marginalizuara përballen me dëmin më të madh mjedisor pa pasur mjete juridike ose korrigjim kuptimplotë.

## **Proceset procedurale mjedisore nuk janë gjithëpërfshirëse dhe u mungojnë konsideratat gjinore**

Një raport për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore të BeH citon shembuj ku ka boshllëqe të qarta në pjesëmarrjen e publikut, duke i përfshirë proceset e lejeve të përdorimit që nuk janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe proceset e lejeve urbane dhe ndërtimore ku pjesëtarët e publikut mund të marrin pjesë vetëm si ndërhyrës pasi ta vërtetojnë se kanë një interes të drejtpërdrejtë juridik (Havránková, 2016). Komunitetet rurale në veçanti përballen me pengesa për të pasur qasje në informacion mjedisor dhe për të marrë pjesë në proceset publike, pasi që infrastruktura është më e dobët ose e pamjaftueshme në krahasim me zonat urbane.

Punëtorja e vuri në dukje se sfidat ligjore dhe ato të avokimit e pengojnë zbatimin e të drejtave procedurale dhe gratë mund të përballen me pengesa shtesë për shkak të diskriminimit gjinor në qasjen në përfaqësimin ligjor dhe avokim për të drejtat e tyre mjedisore. Përmirësimi i kornizave ligjore dhe ngritja e kapaciteteve për drejtësinë mjedisore janë vendimtare për tejkalimin e këtyre sfidave. Konsideratat gjinore mungojnë në raportet dhe diskutimet për proceset procedurale të drejtësisë mjedisore në BeH. Duhet të ketë një vlerësim të mëtejshëm për sfidat dhe pengesat me të cilat përballen gratë nga qasja dhe përfitimi nga këto procese. Kjo do të sigurojë që përpjekjet për t'i adresuar mangësitë e proceseve procedurale për drejtësinë mjedisore janë me përgjegjshmëri gjinore dhe nuk kontribuojnë pa dashje si dhe nuk e përforcojnë marginalizimin e grave në qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi.

## 4 Kosova: Gjendja e angazhimit të grave dhe konsideratat gjinore në drejtësinë mjedisore

### Konteksti dhe sfondi shkurtimisht: Kosovë

Pas Luftës së Dytë Botërore, me Kushtetutën e re të vitit 1974, Kosova u bë Krahinë Autonome në kuadër të Jugosllavisë dhe u njoh si element konstituiv i federatës, duke garantuar autonominë e saj kulturore dhe administrative. Tensionet midis komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës u përkeqësuan gradualisht gjatë gjithë shekullit të 20-të, duke kulmuar me konfliktin e armatosur të viteve 1998–1999. Pas dështimit të ndërmjetësimit ndërkombëtar, NATO nisi një operacion ushtarak në mars 1999, duke detyruar Beogradin të tërheqë forcat e tij. Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e vendosi Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Misionit të Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Në vitin 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli në mënyrë të njëanshme pavarësinë, duke themeluar një strukturë ekzekutive në nivel qendror dhe komunat si njësi themelore të qeverisjes lokale. Angazhimi i Kosovës ndaj Agjendës globale 2030 për zhvillim të qëndrueshëm u dëshmuua nga miratimi unanim i Kuvendit të Kosovës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) në vitin 2018. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës është në fuqi që nga prilli i vitit 2016. Për më tepër, Kosova miratoi një program të rishikuar për integrimin në BE për periudhën 2023-2027. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit është duke vazhduar.

### 4.1 Konteksti gjinor

Gratë përballen me pengesa për mundësi të barabarta në pjesëmarrjen ekonomike, sociale dhe politike në Kosovë. Këto pabarazi janë kryesisht për shkak të modeleve mbizotëruese patriarkale gjinore në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë hapësirat vendimmarrëse, punësimin dhe të hyrat, shëndetësinë dhe sigurinë (Gueye, 2021; Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021), si dhe boshllëqet në qasjen në resurse – gratë posedojnë vetëm 4.9% të tokës dhe 12% të pronës për banim (PEFA, 2022). Qëndrimet dhe besimet shoqërore i pasqyrojnë idealet patriarkale të përhapura. Një studim i vitit 2018 konstatoi se 70% e të anketuarve meshkuj mendonin se burri duhet ta kishte fjalën e fundit për vendimet brenda shtëpisë së tij (OSBE, 2018). Një anketë e vitit 2019 konstatoi se 57% e të anketuarave femra mendojnë se një grua e mirë duhet t'i bindet burrit të saj edhe nëse ajo ka mendim të ndryshëm (OSBE, 2019b).

#### Korniza ligjore

Kosova ka një kornizë solide ligjore dhe mekanizma gjinore për ta promovuar barazinë gjinore. Edhe pse nuk është nënshkruese e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kushtetuta i përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si CEDAW dhe Rezoluta 1325 e OKB-së, si të zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin vendas dhe konsiderohet se mbizotërojnë ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucioneve publike. Kushtetuta i konsideron mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave si vlera themelore demokratike, dhe në vitin 2020 kushtetuta u ndryshua gjithashtu për ta përfshirë Konventën e Stambollit për ta trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave.

Ligji për Barazi Gjinore e promovon barazinë dhe përfaqësimin gjinor në organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe në institucionet e tjera publike, duke e vendosur një kuotë për gratë që t'i përfaqësojnë 50% të anëtarëve. Ligji gjithashtu e mandaton përfshirjen e buxhetimit me përgjegjshmëri gjinore në të gjitha fushat për ta garantuar respektimin e barazisë gjinore në mbledhjen, shpërndarjen dhe alokimin e resurseve (Instituti GAP, 2023). Aspirata dhe praktika e

buxhetimit me përgjegjshmëri gjinore për t'i adresuar pabarazitë gjinore socio-ekonomike, politike dhe kulturore është arritur në një masë të madhe falë veprimeve të organizatave të shoqërisë civile me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024) e përcakton kornizën e përgjithshme për integrimin e barazisë gjinore dhe buxhetimit me përgjegjshmëri gjinore në të gjitha fazat e sistemeve të menaxhimit fiskal qendror dhe lokal. Prej vitit 2018, vlerësimet e ndikimit gjinor janë të detyrueshme kur miratohet ligj apo politikë e re sipas Strategjisë për Rregullim më të Mirë të Kosovës 2.0 (PEFA, 2022). Megjithatë, zbatimi i sanksioneve është i pamjaftueshëm dhe Agjencisë së Kosovës për Barazi Gjinore i mungojnë kompetencat dhe resurset adekuate për ta mbështetur punën e vet (Instituti GAP, 2023; Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021).

## **Përfaqësimi politik dhe vendimmarrja**

Ka pasur progres dhe momente të rëndësishme për gratë në hapësirat vendimmarrëse të Kosovës gjatë disa viteve të fundit. Presidentja aktuale, Vjosa Osmani, ishte kryetarja e parë femër e Kuvendit në vitin 2020 dhe në zgjedhjet e fundit kur e fitoi presidencën, ajo mori numrin më të madh të votave nga cilido kandidat në historinë e Kosovës. Zgjedhjet më të fundit panë gjithashtu një numër rekord prej 43 grave në Kuvend me 120 ulëse, që përfaqësojnë 35.8% të deputetëve. Raportet për angazhimin e grave në vendimmarrje tregojnë se të paktën 30% e anëtarëve të kuvendeve lokale janë gra, por që gratë mbeten të nënpërfaqësuara në pozitat vendimmarrëse në administratë dhe agjenci të pavarura, duke rënë nën mandatet për përfaqësim të barabartë (PEFA, 2022). Një studim i vitit 2017 shprehet se institucionet qendrore dhe lokale në Kosovë nuk e zbatojnë Ligjin për Barazi Gjinore dhe pozitat udhëheqëse e ndikimi priren të dominohen nga meshkujt (Zymberi dhe Zogiani, 2017). Nënpërfaqësimi dhe ndikimi i kufizuar i grave janë për shkak të disa faktorëve, duke i përfshirë normat diskriminuese sociale dhe boshllëqet në arsimim dhe shkrim-lexim; megjithatë, edhe gratë me diploma të avancuara kanë vështirësi për t'u qasur në rolet vendimmarrëse (Zymberi dhe Zogiani, 2017). Gratë në pozitat vendimmarrëse priren të përballen me sfida dhe pengesa që e minojnë autoritetin e tyre, duke e përfshirë kontrollin nga kolegët, ngacmimet, kërcënimet dhe në disa raste dhunën (Zymberi dhe Zogiani, 2017). Një anketë e opinionit publik nga NDI zbuloi se 46% e banorëve pajtohen plotësisht/pajtohen se dhuna ndaj grave në politikë është e përhapur në Kosovë (NDI, 2023b).

## **Angazhimi ekonomik**

Vlerësimet për pjesëmarrjen në fuqinë punëtore në vitin 2022 tregojnë se rreth 49% e meshkujve mbi 15 vjeç janë aktivë në tregun e punës krahasuar me 19.4% të femrave (Banka Botërore, n.d.b). Për 40% të grave, arsyeja kryesore që ato nuk janë aktive në tregun e punës është për shkak të kujdesit dhe përgjegjësive familjare, krahasuar me 3.8% të burrave që janë joaktivë në tregun e punës (Stanko, 2021). Një studim nga Rrjeti i Grave të Kosovës konstatoi se gratë shpenzojnë deri në 300% më shumë kohë në përkujdesje të papaguar dhe aktivitete shtëpiake në krahasim me burrat (Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021). Besimet patriarkale e përforcojnë ndarjen gjinore të punës dhe përgjegjësinë e grave për detyrat shtëpiake. Sipas një ankete të OSBE-së (2018b), rreth 73% e grave deklarojnë se roli i tyre më jetësor është të kujdesen për shtëpinë dhe familjen e vet dhe 72% e burrave besojnë se gratë duhet të kujdesen për fëmijët.

Gratë përballen me praktika diskriminuese punësimi dhe forma të ndryshme diskriminimi në vendin e punës, duke e përfshirë abuzimin seksual dhe ngacmimin që nuk raportohet për shkak të frikës nga shkarkimi ose ndëshkimi (Departamenti i Shtetit i SHBA, 2023). Nën atë vetë-ushqyese, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet etnike pakicë dhe gratë që jetojnë në zonat rurale përballen me sfida dhe pengesa shtesë për shkak të qasjes së kufizuar në pronë

dhe qasjes së pabarabartë në shërbimet publike (Komisioni Evropian, 2023b; Departamenti i Shtetit i SHBA, 2023). Pjesëmarrësit në punëtori vunë në pah se gratë përballen me pengesa të larta për pronësinë e bizneseve dhe tokës, gjë që ndikon në aftësinë e tyre për të përfituar dhe për t'u përfshirë në lloje të ndryshme projektesh. Për shembull, atyre nuk mund t'u ndahen resurse nëse bizneset nuk janë nën emrin e tyre. Veç kësaj, në disa raste grantet ose subvencionet e destinuar për gratë kontrollohen përfundimisht nga bashkëshorti ose anëtarët e tjerë të familjes për shkak të normave diskriminuese kulturore dhe sociale.

## **Dhuna në baza gjinore**

Dhuna në familje dhe DhBGj mbeten të përhapura në Kosovë, dhe 54% e grave thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner intim që nga mosha 15 vjeçare (OSBE, 2018b). Përgjigja e institucioneve dhe ndjekja penale mbeten të dobëta dhe raportet e përshkruajnë reagimin e policisë si të pamjaftueshëm (BTI, 2024b; Gueye, 2021), duke bërë që shumë gra që përjetojnë dhunë nga partneri intim të mos i kontaktojnë shërbimet për mbështetje ose të mos e raportojnë dhunën në polici (OSBE, 2018b). Përkundër legjislacionit për trajtimin e dhunës në familje dhe DhBGj-së, përfshirë Strategjinë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunën ndaj Grave, zbatimi i legjislacionit është sfidues në Kosovë. Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, problemet e përfshijnë mospërfilljen e provave nga institucionet, burgosjen e kufizuar të kryesve, urdhrat e vonuara të mbrojtjes, përcjelljen e pamjaftueshme të urdhrave për mbrojtje dhe llogaridhënien e dobët në rastet kur shkelen urdhrat e mbrojtjes (Farnsworth et al., 2015). Ka gjithashtu kapacitet dhe njohuri të kufizuara në institucionet procedurale për t'i menaxhuar me përgjegjësi rastet e dhunës në familje dhe mungesë resurcesh financiare për t'i mbështetur strehimoret dhe shërbimet (Gueye, 2021). Grupet e të drejtave të njeriut që avokojnë për të mbijetuarat gjithashtu përballen me kërcënime me vdekje dhe ngacmime për shkak të punës së tyre (BTI, 2024b).

## **4.2 Drejtësia distributive - Ndikimet, shqetësimet dhe prioritetet mjedisore me diferencim gjinor**

Çështjet dhe shqetësimet kryesore mjedisore në Kosovë përfshijnë menaxhimin e mbeturinave, ndotjen industriale dhe të ajrit, shpyllëzimin dhe ndotjen e ujit. Këto çështje kanë ndikime të mëdha në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, mirëqenien dhe biodiversitetin, por çështjet mjedisore dhe klimatike janë lënë pas dore prej kohësh në Kosovë (GIZ, 2023; Madhi dhe Trupia, 2022; Ong, 2017). Ka disa arsye për këtë neglizhencë, duke e përfshirë mbështetjen e madhe në thëngjill, financimin e kufizuar, prioritetet konkurruese dhe mungesën e zbatimit të politikave mjedisore (Komisioni Evropian, 2023b; Ong, 2017). Një nga sfidat më të cilat përballen Kosova në adresimin e këtyre shqetësimeve mjedisore buron nga statusi i saj si jo-anëtare e Kombeve të Bashkuara, gjë që e kufizon qasjen në fonde. Një i intervistuar e vuri në dukje se ekziston një mentalitet i eksploatimit, me ndërtime që ndodhin në zona të mbrojtura pa përgjegjësi për dëmtimin e mjedisit.

### **Mungesa e vetëdijesimit dhe prioritizimit të çështjeve mjedisore dhe trashëgimia e aktiviteteve industriale kontribuon në degradimin e mjedisit**

Një temë e fortë si në literaturë ashtu edhe në intervista ishte mungesa e vetëdijesimit dhe prioritizimit të çështjeve mjedisore, me një pakicë të banorëve të Kosovës që e konsiderojnë ndotjen e mjedisit si problemin më të ngutshëm në Kosovë, ndërsa një përqindje e

konsiderueshme konsiderojnë se mjedisi i tyre lokal është shumë i ndotur (BTI, 2024b). Rritja ekonomike dhe zhvillimi i infrastrukturës gjithashtu shpesh kanë prioritet mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, dhe një përfaqësues vuri në dukje një rast të komunës së Obiliqit, e cila u mbështet financiarisht për ta zbutur ndotjen, por i drejtoi fondet për ndërtimin e rrugëve në vend të që të bënte investimet e nevojshme në kujdesin shëndetësor, duke e theksuar ndarjen e gabuar të resurseve.

Gjetjet nga literatura dhe intervistat theksojnë trashëgiminë e aktiviteteve industriale që i kanë kontaminuar zonat përreth Kosovës. Mbetjet industriale, përfshirë këtu ish-lokacionet e minierave, fabrikat dhe aktivitetet e ndërtimit, mund të shpërndahen në ajër gjatë ditëve me erë dhe të derdhen në lumenj dhe tokë gjatë reshjeve, duke çuar në pasoja të përhapura. Në disa raste, mbetjet largohen gjatë proceseve të privatizimit, por deponimi dhe ruajtja e mbetjeve mbetet e paqartë duke përfaqësuar një tjetër rrezik të rëndësishëm. Në përgjithësi, mungojnë përpjekjet rehabilituese për t'i adresuar këto shqetësime.

### **Gratë dhe burrat përballen me ndikime të ndryshme nga degradimi i mjedisit, por vlerësimet dhe hulumtimet për këto dallime janë të kufizuara**

Literatura e disponueshme dhe diskutimet e palëve të interesit tregojnë se ndikimi nga degradimi dhe përfitimet nga zhvillimi i mjedisit ndryshojnë sipas gjinisë, me gratë dhe grupet e marginalizuara në Kosovë veçanërisht të cenueshme ndaj ndikimeve negative nga degradimi mjedisor (Mbrojtësit e të Drejtave Civile, 2023). Qasja dhe përfitimet janë të ndara për shkak të qasjes së pabarabartë në informacion, infrastrukturë dhe shërbime, çka reflektohet në fusha të tilla si reagimi ndaj vërshimeve, mbrojtja e mjedisit, shëndeti, të drejtat pronësore, qasja në financa dhe ndryshimet klimatike. Një e intervistuar vuri në dukje se gratë femëre në zonat rurale nuk kanë njohuri të mjaftueshme për biodiversitetin dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, gjë që ndikon në aftësinë e tyre për të kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe përshtatjen e zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Diskusimet nga punëtorja e validimit theksuan shpërndarjen e pabarabartë të informacionit dhe resurseve, duke e përfshirë mbështetjen financiare, për gratë dhe burrat, si një faktor që e nxit cenueshmërinë e grave ndaj degradimit të mjedisit. Për shembull, subvencionet nga Ministria e Bujqësisë mund të ndahen si për femrat ashtu edhe për meshkujt, por mbështetja e ofruar për meshkujt priret të jetë më e madhe. Kjo u lejon atyre më shumë resurse për ta zhvilluar kapacitetin për përshtatje dhe për t'u mbrojtur kundër goditjeve mjedisore në krahasim me gratë. Veç kësaj, palët e interesit vunë në pah se vlerësimet e dëmeve nga ndikimet mjedisore i anashkalojnë ndikimet në ekonomitë informale, ku gratë përfshihen në mënyrë të konsiderueshme, dhe i marrin parasysh vetëm pronarët e ekonomive familjare dhe bizneseve, të cilët janë kryesisht burra.

Pasojat negative mjedisore priren t'i prekin gratë më rëndë se burrat për shkak të normave dhe traditave kulturore që e kufizojnë qasjen e grave në resurse sociale dhe ekonomike dhe e rrisin ekspozimin e tyre ndaj dëmeve dhe degradimit mjedisor. Normat kulturore, traditat dhe infrastruktura joadekuate ligjore shpesh i favorizojnë burrat në qasjen dhe kontrollin e resurseve natyrore. Si rezultat, gratë përballen me sfida më të mëdha në sigurimin e të drejtave të tyre për resurse natyrore dhe e pësojnë në mënyrë disproporcionale nga ndikimet mjedisore.

---

*“Përkundër parimit të barazisë, shpërndarja e resurseve natyrore nuk është e barabartë ndërmjet burrave dhe grave. Rrjedhimisht, kur lindin çështje mjedisore, gratë e mbajnë një barrë joproporcionale të ndikimit, sepse ato*

*zakonisht mbajnë përgjegjësi për menaxhimin e punëve shtëpiake dhe kujdesin për familjet e tyre. Për shembull, gjatë vërshimeve, gratë janë veçanërisht të cenueshme pasi që ato janë shpesh në ballë të menaxhimit të ekonomive familjare dhe kujdesit. Dështimi për t'i adresuar në mënyrë adekuate çështjet mjedisore e përkeqëson këtë cenueshmëri, duke rezultuar në dëm më të madh për gratë.”*

*- Intervistë me një grua nga bota akademike*

---

Ndikimet e diferencuara gjinore nga degradimi mjedisor dhe ndryshimet klimatike janë përmendur nga disa të intervistuar, por ka një mungesë të dukshme të të dhënave dhe analizave për ndikimet gjinore të degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike në Kosovë (Rashiti et al., 2024).

## **4.3 Drejtësia përfaqësuese - Përfaqësimi i grave dhe konsideratat gjinore në qeverisjen mjedisore**

### **4.3.1 Vendimmarrja mjedisore**

Autoriteti kryesor përgjegjës për vendimmarrjen për mjedisin dhe ndryshimet klimatike është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) (Dietachmair et al., 2024). Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është në varësi të MMPHI-së dhe është përgjegjëse për detyrat profesionale, mbështetëse, shkencore dhe hulumtuese, duke përfshirë monitorimin e mjedisit, dhe jep opinione për VNM-të dhe lejet e ndërtimit (Banka Botërore, 2013). Në nivel lokal, secila komunë ka një njësi mjedisore dhe është përgjegjëse për zbatimin e plotë të parimeve të mbrojtjes së mjedisit sipas ligjit dhe për bashkëpunimin me MMPHI-në për përgatitjen e planeve të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Komunitat gjithashtu e marrin përsipër përgjegjësinë për monitorimin, lëshimin e lejeve të ndërtimit, sigurimin e pajtueshmërisë dhe përdorimin e duhur të tokës dhe mbrojtjen e resurseve natyrore brenda kufijve komunalë (Banka Botërore, 2013).

### **Gratë janë të nënpërfaqësuar në hapësirat për vendimmarrje mjedisore në të gjitha nivelet**

Rolet dhe normat tradicionale gjinore ndikojnë në segregimin profesional, duke kontribuar në nënpërfaqësimin e grave në disa departamente. Puna dhe rolet e kujdesit të grave në shtëpi, të kombinuara me mungesën e orarit fleksibil të punës, mund ta bëjnë të vështirë për gratë që të marrin pozita që kërkojnë më shumë kohë, si p.sh. në udhëheqësi. Përkatësia politike ndikon gjithashtu në qasjen e grave dhe burrave në ngritje në detyrë dhe pjesëmarrje në vendimmarrje. Shumë gra, edhe pse jo të gjitha, ndihen të përjashtuara nga proceset vendimmarrëse sepse janë gra. Për më tepër, të intervistuarit deklarojnë se resurset nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë midis grave dhe burrave dhe gratë kanë më pak qasje në trajnime, rrjetëzim dhe mundësi shkëmbimi.

---

*“Në zonat rurale, si gratë ashtu edhe burrat janë të prekur nga degradimi i mjedisit, por gratë nuk përfshihen në proceset vendimmarrëse.*

*- Nga diskutimet në punëtorinë e validimit*

---

Sipas të intervistuarve, gratë janë të nënpërfaqësuar në MMPHI, veçanërisht në pozitë vendimmarrëse. Përfaqësimi i grave në organet vendimmarrëse mjedisore të nivelit qendror dhe lokal është gjithashtu i ulët. MMPHI-ja vuri në dukje se në procesin e hartimit dhe diskutimit të infrastrukturës ligjore, konsultimet publike drejtohen nga meshkujt, me përfaqësim minimal të femrave ose pa asnjë përfaqësim. Kjo pabarazi gjinore është e evidente në zonat urbane dhe akoma më e theksuar në mjediset rurale, ku mbizotëron dominimi i meshkujve në tubime (shih Kutinë 4).

#### **Kutia 4: Studimi i EcoKosWomen (EKW) për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen mjedisore**

EKW realizoi një studim për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e grave në vendimmarrjen mjedisore në zonat e mbrojtura. Studimi gjeti boshllëqe të shumta që e kufizojnë pjesëmarrjen e grave në këto fusha. Studimi u fokusua në rajonin e Pejës dhe zbuloi se shumë gra që banojnë në zonat e mbrojtura kanë nivele të arsimit fillor dhe mungesë informacioni në lidhje me pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse. EKW ka vërejtur gjithashtu se në shumë raste, ndërkohë që emrat e grave mund të shfaqen formalisht, fuqia vendimmarrëse shpesh i takon burrit që qëndron pas saj. Në komunitet, gratë luajnë një rol të rëndësishëm informal, veçanërisht në promovimin e drejtësisë mjedisore

### **4.3.2 Ligjet dhe politikat mjedisore**

Kosova e ka nënshkruar Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, por marrë parasysh statusin e saj ndërkombëtar, Kosova nuk është palë në asnjë nga konventat mjedisore të OKB-së dhe nuk mund të angazhohet plotësisht në forume shumëpalëshe. Pavarësisht kësaj, Kosova ka bërë përpjekje të përkushtuara për t'i harmonizuar politikat dhe praktikën me strategjitë globale për qëndrueshmëri, duke e përfshirë Agjendën 2030 dhe Marrëveshjen e Parisit. Përkushtimi ndaj mjedisit reflektohet në kushtetutë, kornizën ligjore dhe politikat sektoriale të Kosovës (shih Tabelën 4), të cilat i mbështesin përpjekjet për përafrim me legjislacionin e BE-së për ta mbështetur aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE. Megjithatë, respektimi dhe zbatimi i legjislacionit mjedisor në Kosovë mbetet një sfidë për shkak të financimit të kufizuar, mungesës së kapaciteteve administrative dhe mbështetjes së madhe nga donatorët ndërkombëtarë, si dhe është vonuar miratimi i strategjive mjedisore, duke e përfshirë Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2022-2030 (Komisioni Evropian, 2023b). Një i intervistuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) vëren se mungon kontrolli administrativ mbi vendimet mjedisore në Kosovë, si në nivelin parësor ashtu edhe në atë dytësor, me ministritë apo organet e pavarura që nuk arrijnë të ofrojnë kontroll të kënaqshëm dhe t'i adresojnë në mënyrë adekuate çështjet mjedisore. Për më tepër, mbrojtja e mjedisit renditet ulët për sa i përket prioritetëve të përgjithshme për popullatën krahësuar me punësimin, ekonominë, zhvillimin dhe korrupsionin (Banka Botërore, 2013).

**Tabela 4: Ligjet, politikat, strategjitë dhe zotimet mjedisore në Kosovë**

<b>Kushtetuta</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Neni 7 vendos mbrojtjen e mjedisit si parim.</li> <li>• Neni 52 njuh përgjegjësinë për mjedisin si një e drejtë themelore e njeriut, e cila përfshin mundësinë për t'u dëgjuar nga institucionet publike, shqyrtimin e publikut për çështje që prekin mjedisin e tyre dhe konsiderimin e ndikimit mjedisor nga institucionet publike në vendimmarrjen e tyre.</li> </ul>
<b>Ligjet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 03/L-015 për vlerësimin strategjik mjedisor (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 2004/24 për ujërat e Kosovës (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 2004/30 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 02/L-30 për mbeturina (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 02/L-18 për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore (Gazeta Zyrtare)</li> <li>• Ligji Nr. 08/L-250 për ndryshimet klimatike (Gazeta Zyrtare)</li> </ul>
<b>Politikat dhe strategjitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit 2021-2023</li> <li>• Strategjia e Energjisë për 2022-2031</li> <li>• Dokumenti i Strategjisë për Ujërat 2017-2036</li> <li>• Draft Plani për Energji dhe Klimë (2025-2030)</li> </ul>

*Burimet:* Intervista me palë të interesit në Kosovë; Dietachmair et al. (2024); Banka Botërore (2013)

## **Ligjet dhe politikat mjedisore priren t'i anashkalojnë ose t'i harrojnë konsideratat gjinore**

Në ligjet, politikat dhe strategjitë mjedisore të Kosovës mungojnë konsideratat gjinore dhe ndërlihdhet me mbrojtjen e mjedisit, degradimin e mjedisit dhe ndryshimet klimatike. Kur përfshihen konsideratat gjinore, përmendjet priren të kufizohen dhe të mos mbështeten nga strategji konkrete. Për shembull, Ligji i fundit për Ndryshimet Klimatike zotohet për zbatimin e fushatave të vetëdijesimit për rolin dhe përfshirjen e grave në përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre, si dhe për zhvillimin e udhëzimeve për integrimin e çështjeve gjinore në programin për ndryshime klimatike. Megjithatë, nuk ka informacione se si do të përmbushen këto zotime. Strategjia për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Veprimit përmendin shkurtimisht se strategjia do të synojë ta përmirësojë kapacitetin për përshtatje të komuniteteve të cënueshme, duke i përfshirë gratë, por nuk ka aktivitete shoqëruese të përfshira në planin e veprimit. Sipas MMPHI-së, shumica e strategjive të zhvilluara nga ministria dhe që lidhen me punën e saj janë të verbra nga çështjeve gjinore dhe nuk i referohen legjisllacionit për barazi gjinore.

Një përjashtim i dukshëm është Strategjia e Energjisë e Kosovës 2022-2031, e cila është konstatuar të jetë me përgjegjshmëri gjinore sipas një analize të kryer nga Rrjeti i Grave të Kosovës (Rashiti et al., 2024). Strategjia synon që t'i reduktojë pabarazitë gjinore dhe përfshin një objektiv specifik për pjesëmarrjen e grave me mundësi të barabarta në programet e edukimit dhe trajnimit për energjinë, si dhe vendos caqe për punësimin e grave në sektorin e energjisë.

Në një intervistë me MMPHI-n, u vu re se para vitit 2017, konsideratat gjinore mungonin në shumë politika dhe ligje, përfshirë ato për mjedisin. Përfaqësuesi theksoi se ka pasur një zhvendosje të konsiderueshme dhe të gjitha dokumentet aktuale dhe të ardhshme tani janë duke u hartuar me fokus në barazinë gjinore. Megjithatë, një pengesë e rëndësishme është mungesa e të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë për të informuar zhvillimin dhe zbatimin efektiv të politikave. Veç kësaj, buxhetimi me përgjegjshmëri gjinore do të duhej të zbatohet në mënyrë efektive në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve në përputhje me angazhimet për të siguruar që gjinia të trajtohet në mënyrë efektive në përpjekjet mjedisore (shih Kutinë 5).

#### **Kutia 5: Udhëzues për buxhetim me përgjegjshmëri gjinore nga Rrjeti i Grave të Kosovës**

Rrjeti i Grave të Kosovës ka zbatuar disa përpjekje për ta përmirësuar buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore në Kosovë në përputhje me ligjin. Në vitin 2016, Rrjeti kreu një analizë gjinore të buxhetit dhe financimit për MMPHI-në dhe i dha disa rekomandime për t'i harmonizuar përpjekjet e ministrisë me Ligjin për Barazi Gjinore (Farnsworth et al., 2016). Në vitin 2017, Rrjeti i rishikoi dy dokumente udhëzuese praktike për ta mbështetur buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore në nivel qendror dhe lokal në Kosovë (Farnsworth et al., 2017a; Farnsworth et al., 2017b). Këto dokumente udhëzuese dhe njohuritë nga analiza gjinore për MMPHI-në mund të ndihmojnë në përmirësimin e përpjekjeve për buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore dhe ta mbështesin zbatimin e konsideratave gjinore në veprimet mjedisore në Kosovë.

### **4.3.3 Organizatat mjedisore, avokimi në nivel bazë dhe aktivizmi**

Grupet e shoqërisë civile në Kosovë, duke përfshirë ato të fokusuar në çështjet mjedisore dhe të drejtat e njeriut, luajnë rol kyç në kërkimin e llogaridhënies prej institucioneve për ligjet dhe rritjen e vetëdijesimit dhe ofrimin e mbështetjes për publikun (Alidemaj dhe Haxhiu, 2021). Intervistat me shoqërinë civile në Kosovë theksuan shumë nga këto përpjekje (shih Kutinë 6).

#### **Kutia 6: Përfshirja e shoqërisë civile mjedisore në bashkëpunim, veprime të ndjekjes penale dhe edukim**

Shumë organizata të shoqërisë civile theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet komunale për të promovuar çështjet mjedisore dhe gjinore dhe për ta mbështetur zbatimin. EKW mban partneritete të rëndësishme me zyrtarët gjinorë brenda kornizave komunale, duke i njohur ata si mekanizma integralë dhe të përhershëm për avancimin e nismave për barazi gjinore. OJQ Gjethi ka bashkëpunuar ngushtë me komunën e Kaçanikut në projekte të përbashkëta, duke e përfshirë zhvillimin e Planit Lokal të Mjedisit.

Intervistat me BIRN, OJQ Gjethi dhe Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) vunë në dukje raste të padive të ngritura kundër MMPHI-së. BIRN ngriti dhe fitoi një padi kundër MMPHI-së në lidhje me ndërtimin e një termocentrali nga Contour Global për shkak të shkeljeve ligjore gjatë proceseve të konsultimeve publike. OJQ Gjethi dhe GLPS ngritën një padi kundër MMPHI-së në lidhje me hidrocentralin Lepenci 3, me pretendimin se ministria ka dhënë leje pa marrë në konsideratë ndikimin në mjedis apo duke siguruar pjesëmarrje të mjaftueshme të publikut, duke i shkelur kështu marrëveshjet për koncesione. Përkundër fitoreve në gjykatat themelore, të apelit dhe supreme, lënda kaloi në Gjykatën Kushtetuese, e cila vendosi në favor të hidrocentralit, gjë që e lejoi vazhdimin e operimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Qendra e Avokimit për Kulturën Demokratike (ACDC) bashkëpunoi me BIRN për t'i mundësuar diskutimet për keqpërdorimin e pyjeve, duke e përfshirë prerjen e paligjshme të pemëve, dhe ka nisur veprime ligjore bazuar në informacionin publik të mbledhur nga shtatë komuna në rajonin e Mitrovicës në periudhën 2020-2023.

BIRN e ka marrë një rol aktiv në trajnimet dhe përpjekjet për hulumtime për mjedisin. BIRN ka ofruar trajnime për shumë aktivistë dhe profesionistë të medias për të raportuar në mënyrë efektive për çështjet mjedisore dhe për t'i fuqizuar ata si aktivistë mjedisorë. Veç kësaj, BIRN ka ndërmarrë nisma të ndryshme për ta rritur vetëdijesimin e komunitetit për pasojat e degradimit të mjedisit në rajone të ndryshme, duke i përfshirë parqet kombëtare.

EKW ka zbatuar një sërë kursesh trajnimi që mbulonin tema të tilla si ndryshimet klimatike, praktikat e kursimit të energjisë në ekonomi familjare dhe përdorimin efiçient të pajisjeve. Trajnimi u fokusua gjithashtu në përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë për ta promovuar qëndrueshmërinë. Përfitueset e këtyre trajnimeve ishin gra fermere nga Prishtina, Obiliqi dhe Podujeva.

## **Grupet e shoqërisë civile mjedisore dhe gjinore përballen me sfida për angazhimin në qeverisjen mjedisore**

Përkundër roleve të tyre të rëndësishme në edukim, ngritjen e vetëdijesimit dhe proceset procedurale, organizatat e shoqërisë civile përballen me sfida të rëndësishme në Kosovë (Alidemaj dhe Haxhiu, 2021; UN Habitat, 2022). Një raport për një forum lokal të veprimit për klimën në Kosovë tregoi se mungesa e fondeve për çështjet mjedisore e pengon punën e qëndrueshme të shoqërisë civile. Burimet e kufizuara të financimit do të thotë se këto grupe po konkurrojnë për një grup të vogël fondesh dhe nuk mund të mbajnë staf të përhershëm për të siguruar kapacitete njerëzore afatgjata. Për më tepër, raporti theksoi se grupet e shoqërisë civile janë përballur me probleme në krijimin e rrjeteve me institucionet publike, sektorin e biznesit, botën akademike dhe industrinë (UN Habitat, 2022). Të intervistuarit deklaruan se këto sfida i prekin veçanërisht grupet e shoqërisë civile të fokusuar tek gratë. Përfaqësuesi nga EKW theksoi se prej vitit 2019 nuk ka më mbështetje financiare për grupet e shoqërisë civile nga MMPHI-ja dhe që atëherë nuk ka pasur thirrje për mbështetje. Kjo ka ndikuar në punën e EKW dhe i ka përkeqësuar sfidat për financim, pasi që studimet tregojnë se organizatat për të drejtat e grave përballen me sfida për të pasur qasje në financim të qëndrueshëm me 86% të organizatave që kanë mungesë të resurseve (Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021).

## **Shoqëria civile mjedisore ka kapacitete të kufizuara për konsideratat gjinore**

Informacioni për përfshirjen e grave në aktivizmin mjedisor dhe organizatat e avokimit ishte i kufizuar në shqyrtimin e literaturës dhe të intervistuarit kishin pikëpamje të ndryshme për këtë aspekt të drejtësisë mjedisore. Disa të intervistuar treguan sfida për pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave. OJQ Gjethi ndau pikëpamjen se përballen me sfida në mbledhjen e të dhënave dhe sigurimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të grave dhe vajzave, veçanërisht në rajonet si Ferizaji, Kaçaniku dhe fshatrat përreth. Në mesin e përfaqësuesve të intervistuar të shoqërisë civile, shumë e pranuan rëndësinë e gjinisë dhe grave në avokimin mjedisor, por që aspektet gjinore nuk ishin fokusi i tyre. Për shembull, Let's Do It Peja përfshin të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë në raportet e veta, por nuk fokusohet në ndikimet mjedisore ndaj grupeve të ndryshme shoqërore, duke preferuar t'i adresojë ndikimet në shoqëri në tërësi.

Mungesa e të dhënave për çështjet gjinore dhe mjedisore u vu në pah si faktor kufizues i rëndësishëm dhe kritik për dizajnimin dhe zbatimin efektiv të politikave me përgjegjshmëri gjinore dhe kapacitetet ndërmjet shoqërisë civile dhe vendimmarrësve për ndërlidhjet gjinore dhe mjedisore. Akterët e shoqërisë civile në intervista dhe në punëtorinë e validimit theksuan rëndësinë e këtyre të dhënave për të udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse.

---

*“Një sfidë madhore është mungesa e qasjes në informacion dhe të dhëna në kohë reale dhe në kohën e duhur. Shifrat flasin vetë dhe është e rëndësishme që të kemi më shumë të dhëna dhe informacion për këto çështje.”*

*- Nga diskutimet në punëtorinë e validimit*

---

## **Gratë janë të nënpërfaqësuar në hapësirat e avokimit mjedisor**

Të intervistuarit ndanë disa shembuj të grave që luajnë role kritike në aktivizmin mjedisor (shih Kutinë 7). Megjithatë, u ra dakord që gratë janë të nënpërfaqësuar dhe të marginalizuara në hapësirat e avokimit. Sipas një të intervistuarë nga bota akademike, gratë janë të përfshira në mënyrë aktive dhe japin kontribute në nivelin bazë, por ato janë të nënpërfaqësuar në pozitat vendimmarrëse në institucionet formale dhe nismat e avokimit mjedisor priren të drejtohen nga burrat. Kjo nuk do të thotë se gratë janë më pak të interesuara ose investojnë më pak në çështjet mjedisore, pasi e intervistuarë vëren gjithashtu se:

---

*“Vajzat e reja janë të angazhuara në mënyrë aktive në nismat mjedisore, duke qenë 70% e studentëve në semestrin e dytë të kolegjit. Arsimi, veçanërisht në fushat mjedisore dhe teknologjike, ka një rëndësi të madhe për këto vajza.”*

*- Intervistë me Kolegjin Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM)*

---

### **Kutia 7: SLAPP kundër gruas aktiviste mjedisore**

Në qershor 2020, kundër Shpresa Loshajt, themeluese e OJQ-së Pishtarët, u ngrit një padi për shpifje nga kompania austriake e hidrocentraleve Kelkos Energy sepse ajo kishte folur kundër operacioneve të kompanisë, veçanërisht menaxhimit të katër hidrocentraleve në rajonin e mbrojtur të Deçanit të Kosovës. Bashkë me gjashtëdhjetë OJQ të tjera, Pishtarët i shkruan një letër të hapur Ambasadës Austriake në qershor, duke e pretenduar përfshirjen e Kelkos Energy në praktika të paligjshme, duke e përfshirë funksionimin pa lejet e duhura dhe kontributin në degradimin e mjedisit. Amnesty International përcaktoi se kjo padi ishte SLAPP, pasi që institucionet publike në Kosovë bënë pretendime të ngjashme, por nuk u paditën për shpifje (Amnesty International, 2021). Në tetor 2021, kompania vendosi ta tërheqë padinë (Marí, 2021).

## **Avokimi mjedisor mund të kontribuojë në ndërtimin e paqes dhe kohezionit social**

Shumë të intervistuar i panë nismat e drejtësisë mjedisore dhe avokimit si një pikënisje për t'i mbështetur veprimet kolektive dhe për t'i kapërcyer tensionet sociale. Përfaqësuesit e shoqërisë civile i ndanë pikëpamjet se çështjet mjedisore mund të funksionojnë si një katalizator i rëndësishëm për t'i bashkuar komunitetet, veçanërisht kur ato përballen me sfida të përbashkëta dhe mbrojnë kauza të përbashkëta. Në intervistat me shoqërinë civile u theksuan disa raste kur këto çështje i kanë bashkuar komunitetet (shih Kutinë 8).

---

*“Gratë me prejardhje të ndryshme etnike shpesh bashkohen dhe bashkëpunojnë në nisma kur ndajnë interesa të përbashkëta.”*

*- Intervistë me një grup nga shoqëria civile*

---

#### **Kutia 8: Avokimi mjedisor dhe ndërtimi i paqes**

EKW e ka ndërmarrë projektin “Fuqizimi i Fermereve të Lipjanit”, i cili ka për qëllim fuqizimin e grave nga komuniteti i pakicës serbe në Lipjan. Si pjesë e këtij projekti, grupe të përbashkëta të përbëra nga gra shqiptare dhe gra nga pakica serbe kanë përfituar trajnime për bujqësi të gjelbër, bujqësi të mençur dhe teknika të agropylltarisë së gjelbër. Kjo nismë promovon bashkëpunimin dhe gjithëpërfshirjen midis grave fermere me prejardhje të ndryshme etnike, duke i nxitur praktikatat e qëndrueshme bujqësore dhe duke i fuqizuar gratë në sektorin e bujqësisë.

Let's Do It Peja aktualisht është në proces të themelimit të njëzet këshilleve për ujërat. Teksa këto këshille janë informale, ato e luajnë një rol vendimtar në adresimin e çështjeve të lidhura me ujën në Kosovë. Këshillet janë themeluar duke i adresuar njëzet çështje specifike, dhe dy prej tyre përfshijnë përfaqësues nga komuniteti serb (Graçanicë dhe Mitrovicë e Veriut). Këshillet e tjerë gjithashtu përfshijnë praninë e komuniteteve të ndryshme etnike si romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë dhe goranë. Këto komunitete të etnive të ndryshme bashkëpunojnë për t'i identifikuar dhe trajtuar sfidat e përbashkëta, të ilustruara me përpjekjet e përbashkëta të komuniteteve serbe dhe shqiptare në Shtërpçë dhe në Hanin e Elezit. Këto këshille i mbulojnë katër pellgje ujore në Kosovë dhe përbëhen nga anëtarë të komuniteteve nga rajone të veçanta. Si pjesë e mandatit të tyre, ata aktualisht janë duke kryer analiza ligjore të rasteve të lidhura me ujërat për t'i përcaktuar veprimet e duhura dhe institucionet relevante që do të angazhohen.

## **4.4 Drejtësia procedurale - Konsideratat gjinore në proceset procedurale mjedisore**

Kosova nuk e ka nënshkruar apo ratifikuar Konventën e Aarhus-it, por duke qenë se ajo është një komponente jetike e Nismës Mjedisore për Evropën, Konventa e Aarhus-it zbatohet në Kosovë përmes Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit. Ky ligj i përfshin parimet e mëposhtme sipas nenit 6 që informojnë proceset procedurale mjedisore:

- *Parimi i vigjilencës dhe parandalimit.* Deri në pikën e veprimit të arsyeshëm, duke i konsideruar shpenzimet dhe përfitimet e pritura mjedisore, një aktivitet do të planifikohet dhe zbatohet në atë mënyrë që të parandalojë ose të ndërpresë efektet e dëmshme në mjedis pa rrezikimin e shëndetit të njeriut.
- *Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë:* Çdo person juridik ose fizik dhe publiku, në rast të pësimit të dëmit material ose është para një rreziku të pësimit të dëmit material që ka të bëjë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ligjeve të veçanta ose akteve nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit, ka të drejtë të ngre padi ose të kërkojë nga gjykata kompetente ose institucioni publik të mbrojtje të drejtat e veta.
- *Parimi i qasjes së publikut në informata:* Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.

Kjo mbështetet nga procedurat për lëshimin e lejeve mjedisore dhe kryerjen e VNM-ve, duke e përfshirë Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të miratuar në vitin 2022. Ligji siguron që projektet që kanë ndikim të rëndësishëm mjedisor do të marrin leje ndërtimi vetëm pasi të jetë kryer vlerësimi dhe të vendosen masat e përshtatshme zbutëse.

## **Mungon respektimi dhe zbatimi i proceseve procedurale mjedisore dhe proceset nuk i përfshijnë gratë**

Megjithatë, shumë të intervistuar deklarojnë se zbatimi i legjislacionit për VNM-të është i dobët për shkak të mungesës së kapaciteteve zbatuese dhe vullnetit të kufizuar politik, dhe literatura e disponueshme gjithashtu i përmend sfidat që lidhen me mungesën e stafit dhe resurseve (Ong, 2017; Banka Botërore, 2013). Për më tepër, VNM-të që kryhen shpesh janë të verbra nga pikëpamja gjinore dhe Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është negativ në aspektin gjinor, me gjuhë që i përforcon normat dhe stereotipet gjinore dhe pa dispozitë për të siguruar që analizat gjinore të përfshihen në VNM (Rashiti et al., 2024). MMPHI-ja e konfirmoi këtë boshllëk në VNM, duke theksuar se në VNM-të e kryera nga Ministria nuk janë marrë parasysh ndikimet e diferencuara të degradimit të mjedisit tek gratë dhe burrat.

---

*“Papajtueshmëria [për kryerjen e VNM-ve] është evidente dhe ekziston një shqetësim kritik në lidhje me përfshirjen e kufizuar të grave dhe vajzave në planifikimin, zbatimin dhe proceset e zhvillimit të programeve dhe projekteve.”*

*- Intervistë me një burrë nga një OJQ për politika*

---

Për personat nga komunitetet, dhe në veçanti gratë që jetojnë në veri të Kosovës, ka më pak qasje në gjykata në përgjithësi (Agjencia për Barazi Gjinore e Kosovës, 2020). Përfaqësues nga disa grupe të shoqërisë civile ndanë pikëpamjen se ekziston një mungesë e profesionistëve brenda sistemit të drejtësisë që zotërojnë njohuri gjithëpërfshirëse të rregulloreve aktuale dhe i kuptojnë pasojat e krimeve mjedisore, dhe se gjyqtarëve u mungon ekspertiza në lidhje me çështjet mjedisore dhe drejtësinë mjedisore. Rrjedhimisht, vendimet priren t'i japin përparësi prodhimit të energjisë elektrike pa i marrë parasysh shqetësimet mjedisore.

Pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit theksuan se zhvillimi ekonomik dhe industrial nuk e trajton ndikimin e menjëhershëm dhe afatgjatë në shëndetin e njeriut dhe VNM-të duhet të përfshijnë vlerësime që i theksojnë ndërlidhjet e rëndësishme me shëndetin. Veç kësaj, pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit vënë në dukje se banorët nuk kanë qasje në informacionin nga VNM-të, çka e kufizon aftësinë e tyre për t'u përfshirë dhe për t'u informuar rreth vendimeve përmes proceseve zhvillimore.

## **Ekziston një nivel i lartë mosbesimi se gjyqësori i mbronë të drejtat mjedisore dhe të njeriut**

Qasja në drejtësi në rastet e dëmtimit të mjedisit dhe keqmenaxhimit është sfidë në Kosovë dhe, sipas disa grupeve të shoqërisë civile, është zbehur konfidenca dhe besimi në sistemin e drejtësisë dhe gjyqësorit. Roli i gjyqësorit në menaxhimin mjedisor mbetet i dobët për shkak të një numri të madh të lëndëve gjyqësore dhe efikasitetit të ulët, gjë që ndikon në aftësinë e

gjyqësorit për ta zbatuar legjislacionin mjedisor dhe aftësinë e banorëve për të kërkuar drejtësi (Banka Botërore, 2013).

## **Ka vetëdijesim të kufizuar i banorëve për të drejtat e tyre në proceset procedurale**

Një sfidë e rëndësishme për zbatimin efektiv dhe pajtueshmërinë me proceset procedurale qëndron në atë se sa vetëdijesim kanë banorët në lidhje me të drejtat e tyre sipas legjislacionit dhe nëse ata e kanë informacionin e nevojshëm për t'i ushtruar në mënyrë efektive këto të drejta. Ka nevojë të ngutshme për t'i rritur përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve dhe për ta shpërndarë informacionin rreth të drejtave ligjore në kuadër të mjedisit dhe infrastrukturës, duke sqaruar se si mund të përdoren këto të drejta. Më e rëndësishmja, pjesëmarrësit në punëtorinë e validimit vunë në dukje se gratë shpesh marrin informacion të dorës së dytë nga burrat që e marrin informacionin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se ka vend që informacioni të keqinterpretohet ose të jetë i paplotë deri në momentin që gratë e marrin atë. Është me rëndësi kritike të identifikohen rrugë të ndryshme komunikimi të preferuara dhe të përdorura nga gratë dhe burrat gjatë shpërndarjes së informacionit mjedisor.

Megjithatë, ka pikëpamje dhe opinione të ndryshme se kush është përgjegjës për rritjen e vetëdijesimit dhe sigurimin e zbatimit të ligjeve, me disa të intervistuar që e theksojnë nevojën që shoqëria civile ta marrë përgjegjësinë kryesore. Megjithatë, raporti i Komisionit Evropian i vitit 2023 thekson se Kosova duhet të konsultohet në mënyrë domethënëse me shoqërinë civile, të ndërtojë kapacitete dhe të marrë përgjegjësi për ngritjen e vetëdijesimit mjedisor nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile (Komisioni Evropian, 2023b).

---

*“Teksa legjislacioni ofron mundësi dhe mekanizma të shumtë, shpërndarja e duhur e informacionit është vendimtare. Në fund të fundit, i takon shoqërisë civile dhe komunitetit të përcaktojë se sa efektivisht përdoret legjislacioni”.*

*- Intervistë me një agjenci mjedisore*

---

## 5 Konkluzionet dhe rekomandimet

Ky studim paraqet një përpjekje të rëndësishme dhe fillestare për ta elaboruar fushën prioritare dhe në zhvillim të drejtësisë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore si në BeH ashtu edhe në Kosovë. Ajo që zbulon ky studim është se ka një interes dhe pasion të konsiderueshëm midis palëve të interesit për çështjet e pabarazisë gjinore dhe padrejtësisë mjedisore, si dhe se si adresimi i këtyre çështjeve mund ta mbështesë kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Ekzistojnë gjithashtu mundësi për t'i shfrytëzuar faktorët mundësues dhe përpjekjet e vazhdueshme në BeH dhe Kosovë për t'i mbështetur këto prioritete. Megjithatë, ka gjithashtu boshllëqe kritike në kapacitete, resurse dhe njohuri, të cilat duhet të adresohen për ta realizuar plotësisht drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Gjetjet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet BeH dhe Kosovës përfshijnë me sa vijon.

### **Vlerësimet dhe të dhënat për çështjet gjinore dhe mjedisore janë të pamjaftueshme ose jo të disponueshme.**

Si në BeH ashtu edhe në Kosovë, padrejtësitë distributive të dëmeve dhe përfitimeve mjedisore e pengojnë drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore dhe fuqizimin e grave. Hulumtimet dhe njohuritë e disponueshme nga palët e interesit në BeH dhe Kosovë tregojnë se gratë, veçanërisht në zonat rurale, janë më të ekspozuara dhe të cenueshme ndaj dëmeve mjedisore dhe kanë më pak qasje në resurse dhe shërbime për t'u përballur me dëmet dhe për t'iu përshtatur atyre. Megjithatë, shtrirja e plotë e ndikimeve mjedisore gjinore nuk dihet për shkak të mungesës së vlerësimeve, të dhënave, hulumtimeve dhe analizave formale si në BeH ashtu edhe në Kosovë. As BeH dhe as Kosova nuk e monitorojnë sistematikisht ndikimin e degradimit të mjedisit tek gratë dhe burrat, duke përfshirë shëndetin, të hyrat, mjetet e jetesës dhe mirëqenien e tyre, ose ndikimin e fatkeqësive natyrore tek gratë dhe burrat, duke e përfshirë dëmtimin e pronës dhe mjeteve të jetesës ekonomike, lëndimet, personat e zhdukur apo vdekjet. Adresimi i padrejtësive distributive përmes zhvillimit të politikave të informuara dhe vendimmarrjes gjithëpërfshirëse kërkon investim në vlerësimet formale gjinore dhe mjedisore dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në Kosovë, vlerësimet e ndikimit gjinor janë të mandatuara me ligj në zhvillimin e politikave dhe ligjeve të reja, dhe buxhetimi me përgjegjshmëri gjinore është obligim ligjor për të gjitha institucionet. Ndërkohë që aktualisht mungon zbatimi i këtyre mandateve, përpjekjet për ta përmirësuar pajtueshmërinë në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor, duke e përfshirë mjedisin dhe ndryshimet klimatike, dhe sigurimi që institucionet e përdorin dhe raportojnë për buxhetin e përgjegjshëm ndaj gjinisë, mund të ndihmojnë në mbylljen e boshllëkut kritik të informacionit për gjininë dhe mjedisin në Kosovë.

Në BeH, SMPV 2030+ thekson përdorimin e analizës gjinore, vlerësimeve gjinore, buxhetimit me përgjegjshmëri gjinore dhe auditimeve gjinore për ta mbështetur integrimin gjinor në politikat, programet dhe projektet mjedisore. Deri në momentin e shkrimit, SMPV 2030+ nuk është miratuar zyrtarisht, që do të thotë se zbatimi i strategjive nuk mund të vlerësohet. Kur të miratohet, shfrytëzimi i përfshirjes së këtyre mjeteve në zbatim do të jetë kritik për ta mbyllur boshllëkun e informacionit për gjininë dhe mjedisin në BeH.

### **Ka përfaqësim të pabarabartë në hapësirat vendimmarrëse mjedisore dhe ligjet dhe politikat mjedisore janë neutrale në aspektin gjinor.**

Si në BeH ashtu edhe në Kosovë, gratë janë të nënpërfaqësuar në hapësirat vendimmarrëse mjedisore. Kjo padrejtësi përfaqësuese është një pengesë për drejtësinë mjedisore me

gjithëpërfshirje gjinore. Si BeH ashtu edhe Kosova kanë kuota gjinore për përfaqësimin e grave në pozitat publike, 40% në BeH dhe 50% në Kosovë. Megjithatë, si BeH ashtu edhe Kosova nuk i përmbushin kuotat e përcaktuara dhe zbatimi i legjislacionit është i dobët. Rritja e numrit të grave në hapësirat vendimmarrëse mjedisore nuk është një zgjidhje e vetme, por ka dëshmi për ta mbështetur faktin se përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave në hapësirat vendimmarrëse sjell rezultate më gjithëpërfshirëse, përfaqësuese dhe të qëndrueshme dhe legjislacion më ambicioz mjedisor (Strumskyte et al., 2022).

Një tjetër padrejtësi përfaqësuese si në BeH ashtu edhe në Kosovë është mungesa e konsideratave gjinore në ligjet dhe politikat mjedisore. Ligjet dhe politikat mjedisore në të dyja rastet nuk i njohin ndikimet e ndryshme mjedisore, prioritetet, shqetësimet dhe njohuritë e grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, përveç SMPV 2030+ në BeH dhe Strategjisë së Energjisë në Kosovë. Kjo do të thotë se programet, projektet dhe investimet e formuara nga ligjet dhe politikat nuk po i marrin parasysh dhe nuk po i mbrojnë plotësisht rolet, të drejtat, njohuritë, punën, sigurinë dhe shëndetin, dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve. Kur ligjet dhe politikat përfshijnë përmendje të gjinisë, kjo priret të jetë e përciptë dhe të mos mbështetet përmes objektivave, veprimeve, strategjive, treguesve dhe investimeve specifike.

### **Shoqëria civile mjedisore dhe gjinore dhe gratë aktiviste janë udhëheqëse dhe aktore të rëndësishme, por përballen me pengesa për qeverisjen mjedisore.**

Shoqëritë civile mjedisore dhe gjinore në BeH dhe Kosovë ofrojnë shërbime dhe resurse të paçmueshme për komunitetet, ndihmojnë në avancimin e të drejtave dhe ndihmojnë në kërkimin e llogaridhënies prej akterëve për të drejtat e njeriut dhe abuzimet mjedisore. Megjithatë, financimi u përmend si një sfidë madhore për punën e qëndrueshme të organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht ato të fokusuara në të drejtat e grave. Financimi nga institucionet publike luhet në bazë të prioritetëve politike, ku çështjet mjedisore renditen në nivele të ulëta, dhe me rritjen e normave dhe strukturave patriarkale në hapësirat politike, kërcënohet financimi për punën e shoqërisë civile. Veç kësaj, organizatat e shoqërisë civile kanë ndërveprim të kufizuar kuptimplotë me institucionet publike dhe nuk janë të angazhuara vazhdimisht në vendimmarrje mjedisore. Në BeH dhe Kosovë kishte pikëpamje të ndryshme për rolet e shoqërisë civile dhe institucioneve në menaxhimin e mjedisit, gjë që ndikon në koordinimin efektiv ndërmjet subjekteve.

Në BeH, dhe në një masë më të vogël në Kosovë, roli i grave aktiviste u theksua në përpjekjet për drejtësi mjedisore. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët në të dyja vendet/territoret vunë në dukje se gratë priren të jenë të nënpërfaqësuar në hapësirat vendimmarrëse në grupet e avokimit dhe përfshirja e tyre mund të kufizohet për shkak të normave dhe roleve sociale që ndikojnë në kohën dhe qasjen e grave në këto hapësira. Këto pengesa i prekin gratë në zonat rurale, pasi që ato priren të kenë më pak qasje në resurse financiare, informacion dhe grupe mjedisore në krahasim me gratë që jetojnë në zonat urbane. Në BeH, u vu theks i rëndësishëm mbi kërcënimet gjinore dhe pengesat me të cilat përballen gratë aktiviste në mbrojtjen mjedisore, duke përfshirë stigmën sociale, kërcënimet, dhunën, lodhjen emocionale dhe paditë.

### **Organizatave të shoqërisë civile mjedisore dhe institucioneve u mungojnë kapacitetet për ndërlidhjet gjinore dhe mjedisore.**

Si në BeH ashtu edhe në Kosovë, intervistat me shoqërinë civile zbuluan se këto organizata kanë kapacitete të ulëta dhe baza të dobëta të njohurive rreth ndërlidhjeve gjinore dhe mjedisore. Kapaciteti i kufizuar për sa i përket çështjeve gjinore është një padrejtësi përfaqësuese dhe

pengesë për drejtësinë mjedisore pasi që pikëpamjet, prioritetet, shqetësimet, zërat dhe udhëheqësia e grave nga komunitete të ndryshme mund të mos vlerësohen siç duhet në përpjekjet e shoqërisë civile. Sfidat me të cilat përballet shoqëria civile mjedisore për të përfshirë më mirë konsideratat gjinore në punën e tyre dhe për ta forcuar pjesëmarrjen e grave brenda strukturave organizative përfshijnë mungesën e të dhënave dhe analizave, si dhe kapacitetet e kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare. Organizatat me kapacitete specifike, duke përfshirë EkoFem në BeH dhe EKW dhe Rrjeti i Grave të Kosovës në Kosovë, mund të ndihmojnë në ngritjen e vetëdijesimit dhe kapaciteteve për ndërlidhjet gjinore dhe mjedisore. Veç kësaj, përpjekjet në BeH nëpërmjet Koalicionit Feminist për Drejtësinë Klimatike mund të ndihmojnë për ta kapërcyer boshllëkun në kapacitete dhe për ta inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe sektorëve.

Kufizimet e kapaciteteve gjinore midis institucioneve publike nuk u trajtuan në të njëjtën masë si për shoqërinë civile, por ka boshllëqe të qarta në kapacitete ndërmjet institucioneve mjedisore që duhet të adresohen për ta përmirësuar drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore.

### **Të drejtat procedurale mjedisore nuk zbatohen në mënyrë konsistente ose adekuate, dhe proceseve u mungojnë konsideratat gjinore.**

Një padrejtësi e konsiderueshme procedurale dhe pengesë për drejtësinë mjedisore është se nuk zbatohen të drejtat procedurale të përshkruara në kornizat ligjore si në BeH ashtu edhe në Kosovë. Në mesin e komuniteteve dhe shoqërisë civile kjo ka krijuar mungesë të besimit se institucioneve publike dhe të drejtësisë i respektojnë dhe i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe mjedisit. Sfidat përfshijnë mungesën e vetëdijesimit për të drejtat mjedisore dhe proceset procedurale, veçanërisht në komunitetet rurale, dhe kapacitetin e kufizuar të strukturave të drejtësisë për çështjet mjedisore dhe gjinore. Në Kosovë, gjetjet tregojnë se VNM-të nuk i përfshijnë ndikimet dhe shqetësimet gjinore, dhe proceset e pjesëmarrjes publike nuk janë gjithëpërfshirëse si për gratë ashtu edhe për burrat. Megjithatë, në diskutimet dhe literaturën për të drejtat procedurale mungojnë konsideratat gjinore.

### **Aktivizmi mjedisor mbështet ndërtimin e paqes dhe unifikimin.**

Intervistat në BeH dhe Kosovë riafirmuan potencialin e drejtësisë mjedisore si një rrugë premtuese për nxitjen e unitetit dhe qëndrueshmërisë në shoqëritë pas konfliktit. Shembujt nga të intervistuarit tregojnë se kohezioni social nuk ishte një objektiv fillestar ose i qëllimshëm i projekteve mjedisore dhe përpjekjeve të avokimit, por u shfaq në formë organike pasi që çështjet dhe shqetësimet mjedisore i tejkalonin dallimet sociale. Njohja e ndërlidhjeve midis mbrojtjes së mjedisit dhe ndërtimit të paqes në nivel lokal tregon një vetëdijesim në rritje për përfitimet më të gjera të drejtësisë mjedisore. Duke e vazhduar mbështetjen dhe zgjerimin e nismave të tilla, është e mundur të ndërtohen komunitete më reziliente dhe harmonike. Politikëbërësit, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare duhet të investojnë në programe mjedisore që e theksojnë bashkëpunimin, gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë për ta shfrytëzuar potencialin e plotë të drejtësisë mjedisore si një katalizator për paqen. E rëndësishme është se mund të forcohet roli i grave si aktiviste, udhëheqëse të komunitetit dhe ndërtuese të paqes për përpjekje më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për drejtësi mjedisore dhe tranzicionale.

## 5.1 Rekomandime

Bazuar në gjetjet e hulumtimit, në vijim jepen rekomandimet e politikave dhe ato programore për UNDP-në për t'i adresuar boshllëqet dhe për t'u mbështetur në mundësitë për shfrytëzimin e përfitimeve socio-ekonomike, të barazisë dhe të ndërtimit të paqes nga fuqizimi i grave në drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Rekomandimet i forcojnë konsideratat gjinore dhe përgjegjshmërinë gjinore sipas qasjes së trefishtë të UNDP-së për drejtësinë mjedisore (UNDP, 2022):

1. Krijimi i kornizave ligjore mundësuese në nivel lokal dhe ndërkombëtar, duke aplikuar qasje inovative dhe të bazuara në të drejtat e njeriut për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave mjedisore.
2. Forcimi i institucioneve me qytetarin në qendër dhe i institucioneve efektive, duke siguruar që ato të jenë të qasshme për të gjitha popullatat dhe të pajisura për t'i monitoruar, respektuar dhe zbatuar ligjet mjedisore dhe për t'i promovuar të drejtat mjedisore.
3. Rritja e qasjes në drejtësi dhe fuqizimi ligjor për çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

### 5.1.1 Krijimi i kornizave ligjore mundësuese

#### **Të realizohen, financohen dhe mbështeten analiza dhe mbledhje e të dhënave gjinore dhe mjedisore**

Kornizat ligjore efektive duhet të bazohen në analiza dhe të dhëna të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe relevante. Kryerja e një analize gjinore duhet të jetë pjesë e hartimit të politikave publike. Kjo duhet të përfshijë konsultime dhe koordinim me organizatat e shoqërisë civile mjedisore dhe gjinore, duke u mbështetur në ekspertizën e tyre si dhe ndikimin dhe lidhjet e tyre në komunitete. Palët e interesit theksuan se hulumtimi gjinor dhe mjedisor duhet të mbështetet në nivel lokal dhe të drejtohet nga gratë. Informacioni për nivelin bazë dhe analizat janë kritike për ta mbështetur drejtësinë mjedisore me përgjegjshmëri gjinore dhe për të formuar investime dhe politika më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Mungesa e të dhënave gjinore dhe mjedisore ishte një pengesë qendrore për drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore si në BeH ashtu edhe në Kosovë. Boshllëqet e të dhënave gjinore në sektorët mjedisorë janë çështje në mbarë botën dhe duhet të dedikohen resurse për ta mbyllur këtë boshllëk kritik. Kjo mund të përfshijë:

- Punë të drejtpërdrejtë me shoqërinë civile me fokus në mjedisin dhe gjininë për kryerje të analizave. Për shembull, Rrjeti i Grave të Kosovës ka kryer analiza për çështjet mjedisore dhe ka një rrjet të gjerë të organizatave të shoqërisë civile në mbarë Kosovën për ta mbështetur mbledhjen e të dhënave.
- Ngritje të kapaciteteve të agjencive statistikore për të mbledhur dhe analizuar të dhëna të zberthyera sipas gjinisë, duke përfshirë të dhëna që i mbështesin zotimet ndërkombëtare.
- Ngritje të kapaciteteve të institucioneve publike për ndërlidhjet gjinore dhe mjedisore dhe qasjet me përgjegjshmëri gjinore për hulumtime, mbledhjen e të dhënave, zhvillimin e politikave dhe analizën.
- Sigurimi që analizat dhe të dhënat të jenë në dispozicion të shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

## **Të harmonizohen ligjet dhe zotimet ndërkombëtare dhe lokale për barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe drejtësinë mjedisore dhe të forcohet zbatimi**

Teksa ekzistojnë korniza ligjore për ta promovuar barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin si në BeH ashtu edhe në Kosovë, këto ligje dhe zotime duhet të harmonizohen në të gjithë kornizën ligjore mjedisore. Për shembull, Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë duhet të pasqyrohet në ligjet dhe strategjitë mjedisore, duke i përfshirë mandatet për vlerësimin e ndikimit gjinor dhe buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore. Veç kësaj, proceset e mbështetura nga UNDP-ja për të zhvilluar ligje dhe politika të reja ose të rishikuara duhet të identifikojnë dhe t'u përmbahen mandateve gjinore për t'i inkorporuar konsideratat gjinore plotësisht dhe që nga fillimi i procesit. Kjo mund të mbështetet përmes:

- Rritjes së bashkëpunimit si dhe kapaciteteve për të kryer integrimin gjinor në politikat mjedisore.
- Sigurimit të përfshirjes së grave dhe grupeve të shoqërisë civile të fokusuar në gjini në grupet punuese dhe mbështetjes së tyre si partnere në hulumtime dhe hartimin e politikave dhe strategjive mjedisore.
- Rritjes së vetëdijesimit për të drejtat dhe kornizat ligjore midis palëve të ndryshme të interesit dhe shpërndarjes së njohurive për ligjet, funksionet dhe përfitimet e ndryshme mjedisore për publikun.
- Krijimit të themelit të bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe strukturave të administratës për të siguruar konsultime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme ndërmjet këtyre akterëve të rëndësishëm.

## **Të realizohet një vlerësim gjinor i legjislacionit mjedisor**

Palët e interesit në Kosovë treguan nevojën për një vlerësim gjinor të legjislacionit mjedisor për ta siguruar përafrimin dhe pajtueshmërinë me strategjitë dhe zotimet për zhvillim të qëndrueshëm, duke e përfshirë Agjendën 2030. Ky proces mund të informohet nga nisma dhe raporti i fundit nga UNDP BeH, *Raport për Hartëzimin e Komponentit Gjinor në të Dhëna dhe Legjislacion në fushën e Ndryshimeve Klimatike, Mjedisit dhe Biodiversitetit* (Eskić-Šihljak dhe Knezheviq, 2022).

## **Të integrohen kërcënimet, ndikimet dhe shqetësimet e diferencuara gjinore dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në VNM**

Duhet të elaborohen udhëzimet dhe mandatet për sektorin privat dhe institucioneve publike për kryerjen e VNM-ve për t'i përfshirë vlerësimet e ndikimit gjinor si pjesë e procesit. Një rrugë për ta mbështetur këtë përpjekje mund të jetë zhvillimi i një Plani Kombëtar të Veprimit për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (OHCHR, 2016).

### **5.1.2 Forcimi i institucioneve efektive dhe me qytetarin në qendër**

## **Të ngrihen kapacitetet e shoqërisë civile mjedisore për çështjet gjinore dhe mjedisore, integrimin gjinor dhe qasjet me përgjegjshmëri gjinore**

Duhet të ketë mbështetje të përkushtuar për shoqërinë civile mjedisore për të ndërtuar kapacitetet gjinore përmes:

- Trajnimeve dhe punëtorive të dedikuara për qasjet me përgjegjshmëri gjinore, si dhe informacionit për mandatet gjinore për donatorët kryesorë mjedisorë.
- Rrjeteve dhe grupeve punuese ndërmjet shoqërisë civile gjinore dhe mjedisore për ta rritur bashkëpunimin dhe ndarjen e njohurive.
- Përfshirjes së shoqërisë civile dhe shfrytëzimit të ndikimit të saj për ta udhëhequr zhvillimin e kapaciteteve në zbatimin e standardeve mjedisore dhe gjinore evropiane dhe globale.

Këto përpjekje duhet t'i shfrytëzojnë pikat e forta ekzistuese si në BeH ashtu edhe në Kosovë. Për shembull, në BeH, Qendrat e Aarhus-it mund të funksionojnë si pika të mbledhjes për të organizuar trajnime dhe aktivitete vetëdijesimi për gjininë dhe mjedisin për vendimmarrësit mjedisorë, OJQ-të, profesionistët, organizatat në nivel bazë dhe palët e tjera të interesit. Veç kësaj, EkoFem në BeH dhe EKW dhe Rrjeti i Grave të Kosovës në Kosovë mund të ndihmojnë në mbylljen e boshllëkut të njohurive për çështjet gjinore dhe mjedisore.

### **Të zhvillohen nisma për financim që e mbështesin udhëheqësinë e grave në shoqërinë civile mjedisore**

Mbështetja e grave dhe shoqërisë civile me fokus në gjininë kërkon zhvendosjen dhe rritjen e qasjes në burimet e financimit (Gratë realizojnë, 2019). Kjo mund ta përfshijë ndarjen e buxhetit të qartë për shoqërinë civile për ta forcuar punën e saj në lidhje me mjedisin dhe gjininë, duke e përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e politikave dhe planeve të veprimit për ta përmirësuar angazhimin e grave në organizata.

Për t'i adresuar sfidat financiare me të cilat përballet shoqëria civile e fokusuar në mjedis dhe gjini, duhet të sigurohen burime të sigurta financimi dhe zotime që mbeten në fuqi për një periudhë më të gjatë (p.sh. zotim 10-vjeçar) dhe përgjatë dhe përmes institucioneve dhe përpjekjeve të donatorëve ndërkombëtarë. Kjo do të sigurojë stabilitet afatgjatë për shoqërinë civile për t'i adresuar çështjet që kërkojnë angazhim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë barazinë gjinore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe ndërtimin e paqes.

### **Të përshkruhen qartë kërkesat dhe udhëzimet e donatorëve për financim për ta përmirësuar qasjen për organizatat e shoqërisë civile dhe për t'i zhvendosur strategjitë e financimit drejt fuqizimit dhe përfitimeve të drejtpërdrejta për shoqërinë civile dhe organizatat në nivel bazë**

Palët e interesit në BeH treguan se politikat e donatorëve duhet të përvijohen qartë dhe të miratojnë një qasje nga poshtë lart për financimin. Duhet të zhvillohen udhëzime të qarta për financimin nga donatorët kryesorë, ku përfshihet edhe informacion për kërkesat dhe mandatet gjinore, si dhe burimet për mbështetje për përmbushjen e këtyre mandateve (si grantet, rrjetet e grave, etj.). Udhëzimet për politikat e donatorëve duhet të përfshijnë fokus të veçantë në përmirësimin e qasjes në financa për shoqërinë civile të fokusuar tek gratë, OJQ-të rurale dhe organizatat në nivel bazë që mund të përballen me pengesa në informim dhe kapacitete për fondet e donatorëve.

### **Të përmirësohen mekanizmat koordinues ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve për drejtësi mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore**

Krijimi i lidhjeve ndërmjet institucioneve mjedisore, gjinore, të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë me ministritë për mjedis dhe çështje gjinore do të jetë me rëndësi kritike për ta nxitur

përparimin në drejtësinë mjedisore me gjithëpërfshirje gjinore. Kjo mund ta përfshijë koordinimin dhe ndarjen e njohurive ndërmjet shoqërisë civile rurale dhe urbane, si dhe bashkëpunimin ndërmjet shoqërisë civile dhe ministrive. Për shembull, në Kosovë, EKW bashkëpunon me mekanizmat gjinorë të nivelit lokal dhe qendror pasi që këta mekanizma ekzistues janë integral për avancimin e nismave për barazi gjinore.

### **Të mbështeten gratë aktiviste përmes mjeteve ligjore, shërbimeve, resurseve dhe mjeteve financiare të synuara**

Duhet të bëhen përpjekje të shtuara për ta identifikuar mbështetjen e nevojshme për gratë aktiviste në drejtësinë mjedisore. Këtu mund të përfshihet reforma ligjore për veprën penale të shpifjes për aktivistet mjedisore, veçanërisht për kërcënimet gjinore dhe dhunën ndaj grave aktiviste, si dhe avokimi për mekanizma më të plotë të llogaridhënies dhe mbrojtja kundër SLAPP-ve.

#### **5.1.3 Rritja e qasjes në drejtësi dhe fuqizimi ligjor**

##### **Të ngrihen kapacitetet e sistemit gjyqësor për ligjet mjedisore dhe gjinore**

Strukturat e gjyqësorit kanë nevojë për mbështetje specifike për t'i përmirësuar kapacitetet për çështjet mjedisore dhe gjinore, veçanërisht në zonat rurale. Këtu mund të përfshihen:

- Inkorporimi i gjinisë dhe mjedisit në kurrikulën e arsimit dhe trajnimit ligjor.
- Zhvillimi i trajnimeve specifike me institucionet, agjencitë përgjegjëse, avokatët, gjyqtarët, policinë dhe komunitetet për zbatimin e ligjeve mjedisore.
- Trajnimi i juristëve dhe avokatëve në zonat rurale për ligjet dhe praktikatat më të mira gjinore dhe mjedisore.
- Lehtësimi i sesioneve për legjislacionin, konventat dhe praktikatat e mira ligjore për barazinë gjinore me profesionistë ligjorë mjedisorë.

##### **Të ngrihen kapacitetet e shoqërisë civile, organizatave në nivel bazë dhe aktivistëve për të pasur qasje në informacion dhe drejtësi për çështjet mjedisore**

Përmirësimi i qasjes në informacion dhe drejtësi duhet ta përfshijë kapacitetin për gjetjen e rrugës mes sistemeve ligjore dhe resurseve si dhe shërbimeve për ta mbështetur shoqërinë civile, organizatat në nivel bazë dhe gratë aktiviste që të kenë qasje të sigurt në drejtësi. Këtu mund të përfshihen:

- Krijimi i fondeve ligjore emergjente për organizatat në nivel bazë dhe gratë aktiviste
- Punëtori për kornizën ligjore dhe gjetjen e rrugës në sistemin e drejtësisë
- Lista e verifikuar e shërbimeve dhe resurseve për çështjet ligjore – duke përfshirë avokatë të njohur dhe të përkushtuar ndaj të drejtave të grave
- Baza e të dhënave për vendimet e gjykatave për çështje mjedisore për të identifikuar lehtësisht rastet dhe vendimet me aspekte gjinore.
- Ndhimë juridike falas në lidhje me çështjet mjedisore, veçanërisht për organizatat në nivel bazë dhe aktivistët.
- Krijimi i infrastrukturës së qartë dhe të qasshme të komunikimit dhe digjitale për proceset dhe gjetjet e VNM-ve.

- Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për të shërbyer si mundësues të konsultimit publik dhe roli i tyre në ngritjen e kapaciteteve të komunitetit për teknikat dhe procedurat e pjesëmarrjes publike.
- Aplikimi i masave shtesë për të siguruar konsultime publike cilësore me përfaqësimin gjinor për ta shmangur manipulimin e këtyre proceseve.

Veç kësaj, nevojiten përpjekje për t'i ngritur njohuritë dhe shkathtësitë e grave në komunitetet rurale, të cilat përballen me sfida më të mëdha në qasjen në informacion dhe resurse të drejtësisë.

# Aneksi 1: Kornizat e shqyrtuara ekzistuese të drejtësisë mjedisore dhe të drejtësisë gjinore

Korniza	Përshkrimi
<p><b>Kornizat konceptuale të drejtësisë mjedisore</b></p> <p><a href="#">Blue et al., 2020</a>; <a href="#">Steger, 2007</a></p>	<p>Kornizat konceptuale të drejtësisë mjedisore përcaktojnë atë sipas tre kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Drejtësia distributive</i> i referohet shpërndarjes së barrës dhe përfitimeve mjedisore në shoqëri ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore.</li> <li>• <i>Drejtësia procedurale</i> (nganjëherë referuar si përfaqësim) i referohet se kush është i përfshirë dhe ka ndikim në aspektin e vendimmarrjes mjedisore.</li> <li>• <i>Drejtësia e njohjes</i> ka të bëjë me interesat, vlerat dhe pikëpamjet e kujt njihen dhe merren parasysh</li> </ul>
<p><b>UNECE Konventa për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për Çështjet Mjedisore.(Konventa e Aarhus-it)</b></p> <p><a href="#">UNECE, 1998</a></p>	<p>Marrëveshja kryesore ndërkombëtare për demokracinë mjedisore që garanton tre të drejta procedurale për çështjet mjedisore: (1) qasja në informacionin mjedisor, (2) pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe (3) qasja në drejtësi për çështjet mjedisore.</p>
<p><b>Drejtësia mjedisore: Sigurimi i të drejtës sonë për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm</b></p> <p><a href="#">UNDP, 2022</a></p>	<p>UNDP-ja e kupton lidhjen ndërmjet krizës mjedisore dhe sfidave ndaj të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, dhe se si këto elemente duhet të jenë komponente kyçe për ta adresuar krizën përmes promovimit të drejtësisë mjedisore. Konceptet dhe qasjet e UNDP-së ndaj drejtësisë mjedisore shpjegohen si të trefishta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i kornizave ligjore mundësuese</li> <li>• Forcimi i institucioneve efektive dhe me qytetarin në qendër</li> <li>• Rritja e qasjes në drejtësi dhe fuqizimi ligjor për çështjet e ndryshimeve klimatike mjedisore.</li> </ul>
<p><b>Korniza analitike e Harvardit, Korniza konceptuale Moser për analizën dhe planifikimin gjinor, dhe Korniza konceptuale Levy</b></p> <p>Të përmbledhura së bashku nga <a href="#">EIGE, 2019</a></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Korniza analitike e Harvardit</i>: Përdoret për t'i identifikuar dhe kuptuar dallimet midis burrave dhe grave në pjesëmarrjen e tyre në ekonomi. Korniza përshkruan kush bën çfarë aktiviteti, kush ka qasje dhe kontroll mbi resurset, si dhe ndikimet e roleve gjinore.</li> <li>• <i>Korniza konceptuale Moser</i>: Bazuar në konceptet e roleve dhe nevojave gjinore në sferat prodhuese, riprodhuese dhe komunitare.</li> <li>• <i>Korniza konceptuale Levy</i>: Trajton integrimin gjinor në institucionet për planifikimin e zhvillimit.</li> </ul>
<p><b>Kornizat ligjore për hapësirën qytetare</b></p> <p><a href="#">UNDP, 2021</a></p>	<p>Ofron një pasqyrë të standardeve të të drejtave të njeriut të zbatueshme për hapësirën qytetare. Korniza fokusohet në liritë e shprehjes, tubimit dhe shoqërimit bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përfshin udhëzime për legjisllacionin për t'u përfaqësuar me këto standarde. Gjithashtu i përshkruan ligjet dhe rregulloret kryesore që e prekin shoqërinë civile në fushat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cikli jetësor i OSHC-ve</li> <li>• Rregullimi fiskal i OSHC-ve</li> <li>• Marrëdhëniet shtet/territor-shoqëri</li> <li>• Pjesëmarrja publike</li> </ul>

<p><b>Korniza e qasjes së marrëdhënieve sociale për analizën gjinore</b></p> <p><a href="#">ITC-ILO, n.d; Equilo, n.d.</a></p>	<p>Metoda për analizimin e pabarazive ekzistuese gjinore në shpërndarjen e resurseve, përgjegjësive dhe pushtetit dhe dizajnimin e politikave dhe programeve që u mundësojnë grave të jenë agjente të zhvillimit të tyre. Bazohet në marrëdhëniet e pushtetit dhe mënyrës si riprodhohet pabarazia gjinore dhe sociale përmes një sërë institucionesh – duke përfshirë shtetin/territorin, tregun, komunitetin dhe familjen.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullat - si bëhen gjërat</li> <li>• Aktivitetet - çfarë bëhet</li> <li>• Resurset - çfarë përdoret dhe prodhohet</li> <li>• Njerëzit - kush është brenda, kush është jashtë, kush bën çfarë</li> <li>• Pushteti – kush vendos dhe interesat e kujt u shërbejnë</li> <li>• Politikat gjinore – të klasifikuara si të verbra, neutrale, të ndjeshme ose pozitive ndaj gjinisë</li> </ul>
<p><b>Drejtësia klimatike feministe: një kornizë për veprim</b></p> <p>UN Women <a href="#">(Turquet et al., 2023)</a></p>	<p>Ofron qartësi konceptuale për pengesat ndaj drejtësisë klimatike feministe dhe se si veprimi publik mund ta nxisë përparimin në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët. Katër dimensionet e kornizës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Njohja</i> dhe respektimi i identiteteve, përvojave dhe njohurive të ndryshme</li> <li>• <i>Rishpërndarja</i> e resurseve</li> <li>• <i>Përfaqësimi</i> dhe pjesëmarrja domethënëse e grave dhe grupeve të marginalizuara në vendimmarrjen për klimën</li> <li>• <i>Reparacionet</i> për dëmet e së shkuarës dhe të së ardhmes</li> </ul> <p>Korniza përfshin gjithashtu dy parime ndërsektoriale: <i>Ndërvarësia</i> njeh ndikimin e marrëdhënieve me njëri-tjetrin, me natyrën dhe me mekanizmat globalë për drejtësinë klimatike. <i>Ndërseksionaliteti</i> pranon se pabarazitë sociale dhe dinamikat e pushtetit janë komplekse dhe të shumanshme dhe i formësojnë përvojat e dënimeve dhe privilegjeve.</p>
<p><b>Hartëzimi i komponentit gjinor në të dhëna dhe legjislacion në fushën e ndryshimeve klimatike, mjedisit dhe biodiversitetit</b></p> <p>UNDP <a href="#">(Eskić-Šihljak dhe Knežević, 2022)</a></p>	<p>Ofron pasqyrë dhe informacion për përfshirjen gjinore në të dhënat statistikore dhe dokumentet ligjore në lidhje me ndryshimet klimatike, çështjet mjedisore dhe biodiversitetin në Bosnjë dhe Hercegovinë. Korniza e hartëzimit bazohet në vizionin dhe qëllimet globale të Koalicionit Gjinor dhe Klimatik dhe përfshin informacion për pronësinë e tokës; qasjen në ushqim, energji dhe ujë dhe kanalizime; ndryshimet klimatike dhe shëndetin; konsumin e energjisë; vendimmarrjen mjedisore; tregjet e punës; arsimimin; dhe aktet ligjore në vend.</p>

## Aneksi 2: Informacioni për intervistat me palë të interesit dhe punëtoritë e validimit

### Pjesëmarrësit në intervista dhe punëtoritë e validimit

<b>Bosnjë dhe Hercegovinë</b>	
<i>Intervista</i>	<i>Punëtoritë e validimit</i>
<p>Të kryera në shkurt dhe mars 2024</p> <p>11 intervista me 14 persona (12 gra, 2 burra)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 3 intervista me institucionet publike</li> <li>• 4 intervista me shoqërinë civile dhe organizatat në nivel bazë</li> <li>• 3 intervista me gra aktiviste</li> <li>• 1 intervistë me një nismë feministe</li> </ul>	<p>17 maj 2024 në Zenicë në OJQ Eko Forum Zenica</p> <p>18 persona (16 gra, 2 burra) – event hibrid me pjesëmarrës online dhe prani fizike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nr. nga shoqëria civile</li> <li>• nr. i aktivistëve</li> <li>• nr. i mediave</li> <li>• 1 nga institucionet publike</li> <li>• 1 nga sektori privat</li> </ul>
<b>Kosovë</b>	
<i>Intervista</i>	<i>Punëtoritë e validimit</i>
<p>Të kryera në shkurt dhe mars 2024</p> <p>9 intervista me 14 persona (7 gra, 7 burra)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 intervista me autoritete publike</li> <li>• 3 intervista me shoqërinë civile</li> <li>• 2 intervista me aktivistë dhe organizata avokimi</li> <li>• 1 intervistë me akademik</li> <li>• 1 intervistë me media</li> </ul>	<p>21 maj 2024 në Prishtinë në Hotel Sirius</p> <p>19 persona (15 gra, 4 burra)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 13 nga shoqëria civile (nga 10 grupe)</li> <li>• 2 aktivistë</li> <li>• 2 institucione</li> <li>• 1 nga bota akademike</li> <li>• 1 nga organizata ndërkombëtare</li> </ul>

### Pyetjet për intervistat me palët e interesit

Intervistuesit identifikuan disa nga pyetjet nga tabela e mëposhtme, duke përfshirë pyetje më specifike për grupet e palëve të interesit, bazuar në të intervistuarin. Këto pyetje u përdorën si udhëzues për intervistat e thelluara.

